

LEXMARK  
LEGAL

KENI NEVOJË PËR KËSHILLA TË EKSPERTËVE PËR  
IMIGRACIONIN NË MB? MOS KËRKONI MË TEJ!

EKIPI YNË I AVOKATËVE ME PËRVOJË TË IMIGRACIONIT ËSHTË I  
SPECIALIZUAR NË:

- APLIKIMET PËR VIZË
- VENDBANIM TË PËRHERSHËM
- SHTETËSIA
- RASTET E AZILIT
- APELET PËR DËBIM

NE JEMI KËTU PËR T'JU UDHËHEQUR NË ÇDO HAP  
TË RRUGËS. SUKSESI JUAJ NË EMIGRACION  
ËSHTË MISIONI YNË!

KONTAKTONI LEXMARK LEGAL SOT PËR NJË TË ARDHME MË TË  
NDRITSHME NË MB. PARTNERI JUAJ I BESUAR I IMIGRACIONIT!

ANA: 07435119343 Office: 0208 090 2488  
ALDO: 07494181220  
SANTJOLA: 07742877853

The Winning Box, Aquis House,  
27-37 Station Road, Hayes, UB3  
4DX



# The Albanian

VITI I 20 I BOTIMIT 25 TETOR 2023

Tel: 020 7018 7929 30 Avenons Road London E13 8HT

## FINALIZOHET MARRËVESHJA TË DËNUARIT NË BRITANINË E MADHE TRANSFEROHEN NË SHQIPËRI



PETRIT KUÇANA

**DOMOSDOSHMERIA  
E PËRFSHIRJES  
SË DIASPORËS**




**KRYEMINISTRI I QEVERISË  
SË PARË TË PALESTINËS  
KA QENË SHQIPTAR**

DAUT DAUTI



**RENDI I  
NGRIRË**

DITMIR BUSHATI



**ARRITJA NË ÇAK  
PA DY RROTA**

VETON SURROI



**U PROVUA PLOTËSISHT SE  
REFORMA NË DREJTËSI U DIZENJUA  
PËR TË SHKATËRRUAR OPOZITËN**

YLLI MNJANI



**PARLAMENTI EUROPIAN  
E PA SERBINË  
ME SYTË E ALBIN KURTIT**

ANDI BEJTJA



# Akoma nuk keni një website?

## Akoma nuk jeni regjistruar në Google

Për çdo konsultim mund te vini në çdo kohë në zyrat tona

Adresa e zyrave: 30 Avenons Road, London, E13 8HT  
Tel:020 7018 7929 Mob: 073 4066 5946 Mob:078 5997 7545




The Albanian newspaper in London

**THE ALBANIAN**  
www.thealbanian.co.uk

www.thealbanian.co.uk

albania7@gmail.com

Tel: 020 7018 7929



PETRIT KUÇANA

Tejskashmërisht e papërfillshme vazhdon të mbetet diaspora shqiptare thuajse në çdo aspekt të jetës në Shqipëri. Natyrshëm është lehtësisht e konstatueshme kontradiksi mes perceptimit të diasporës si bankë që dërgon para. Përceptazi nënkuptohet fenomeni i shtimit të jashtëzakonshëm të numrit të shqiptarëve që jetojnë jashtë. Rrallë flitet (qoftë edhe flitet) për diasporën si fenomen dhe jo si domosdoshmëri

## DOMOSDOSHMERIA E PËRFSHIRJES SË DIASPORËS

për përfshirje. Numrat nga 1.4 deri në 1.6 milionë shqiptarë që jetojnë jashtë ndonëse tepër kokëfortë në vetvete duket se nuk përbëjnë asnjë, qoftë edhe shtysë për ndërmarrjen e veprimeve konkrete në angazhimin e diasporës.

Mbase do të ishte humbje kohe dhe për shumë kënd mund të tingëllonte cinike të bëhej një kronologji e marrëdhënies shtet-diasporë. Së paku në dekadën e fundit mund të konstatohet lehtësisht kalimi i caqeve të shpërfilljes së diasporës.

Të ashtuquajturit samitet e diasporës, krijimi i një ministrie për diasporën apo institucione të tjera rezultuan pak a shumë lojë pa asnjë strategji të qartë, thjesht lajm përbërës për konsumin e përditshëm.

Këto lajme asesi nuk mund të kthehen në argumente të premtiveve të njëpasnjëshme dhe herëpashershme të pushtetarëve shqiptarë. Sot e kësaj dite nuk është arritur që të ketë një regjistër për shqiptarët në diasporë. Asnjëherë nuk u vu në jetë premtimi për regjistrimin e diasporës që do të rezultonte në atë që është kërjtësisht normale në çdo vend të botës, e drejta votës për diasporën shqiptare.



Nuk është e tepërt të ripërsërisim se shqiptarët e shqipërisë janë të vetmit që nuk kanë të drejtën e votës në vendet ku ata jetojnë që do të ishte gjëja më normale e mundshme. Klasa politike shqiptare nuk arriti asnjëherë të realizonte këtë dhe pasojat po duken të jenë gati tragjike në jetën demokratike në mëmëdhe. U kthyen në vaj

medet ato premtime të furishme të kryeministrit aktual për të drejtën e votës. Të njëjtin fat patën edhe institucionet e tjera që kishin si bishit diasporën. Vetëm një KKD (Këshilli kombëtar i Diasporës) ka shpëtuuar dhe mjerisht po dëshmohej se po përdoret nga kryeministri për të prodhuar ndonjë lajm apo për të gjetur strehë nga ku

mund të buçasë plani i tij për të ashtuquajturën amnisti fiskale që gjerësisht besohet që ska të bëjë fare me diasporën.

Deri më sot nuk kemi pare një plan, një strategji qoftë edhe afatshkurtër për angazhimin e diasporës.

Burimet njerëzore mund të konsiderohen si pasuri e jashtëzakonshme e një kombi, por që në rastin e shqipërisë askush nuk e vë ujin në zjarr qoftë edhe për identifikimin e tyre.

Nëse do të mendonim për pafundësinë e doktorëve të shkencave, apo ambasadorëve të jashtëzakonshëm që përfaqësojnë më së miri vlerat shqiptare në botë në çdo fushë të jetës, së paku do të ishte keqardhje.

Çfarë po ndodh me biznesmenët në diasporë dhe si është e mundur që kurrë nuk u ofruan për të investuar në mëmëdhe qoftë si investitorë strategjikë ose jo. Mjerisht diaspora duket se për pushtetarët është e mjaftueshme të numërohet si turist. Çdo ditë e më shumë po kuptohet domosdoshmëria e përfshirjes së diasporës desi sa të jetë shumë shumë vonë.

Ribotim

## AVOKATET E EMIGRACIONIT PËR SHQIPTARËT NË UK

**HA** Haris Ali Solicitors

If you are a child born in the UK with no immigration status, after 7 years in the UK you can apply straightaway for indefinite leave to remain (ILR).

Call: 0208 8570 7300 | Mobile: 07967 467414 | [www.harisalisolicitors.co.uk](http://www.harisalisolicitors.co.uk)

19 Kingsley Road, Hounslow, London. TW3 1PA



**Imperium  
Chambers**

**Tel: 0207 242 3488**

**Address: 2 Selkirk Road,  
London SW17 0ES**

Email: [enquiries@imperiumchambers.co.uk](mailto:enquiries@imperiumchambers.co.uk)

Website: [www.imperiumchambers.co.uk](http://www.imperiumchambers.co.uk)

YouTube: The Immigration Barrister

**A JENI MARTUAR PAS DATËS  
31 DHJETOR 2020 DHE JU  
ËSHTË REFUZUAR APLIKIMI  
I EU SETTLEMENT SCHEME  
(EUSS)?**

**DONI TË APELONI ÇESHTJEN  
TUAJ NË SHKALLËN E PARË  
APO TË DYTË TË APELIT?**



**ME NJË GARANCI SUKSESI TË LARTË NË TË GJITHË APELET BARISTERËT TANË TË KUALIFIKUAR  
DHE ME EKSPERIENCË E NDJEKIN ÇESHTJEN TUAJ NGA FILLIMI NË FUND**

**SHERBIMET QE OFROJME NE ÇESHTJET E EMIGRACIONIT PERFSHIJNE**

Human Rights

Judicial Review

Appeals

(we have in house barristers)

Fresh claims

Asylum

Overstayers

Stateless

Detention & Bail

EEA family permit

EEA Permanent Residence

Indefinite Leave to Remain (ILR)

Nationality

Spouse Visa

Visitor Visa

Dependent children

Student,

Work & Entrepreneur Visa

Jemi te specializuar ne aplikimet per nderrimin  
e shtetesise nga **Kosovar** ne **Shqiptar**

**Per me shume informacion kontaktoni Adelen**

Fully accredited by the  
Bar Standard Board



**BAR  
STANDARDS  
BOARD**

Imperium Chambers

4.8 ★★★★★ (141) ⓘ

Lawyer in London, England · [Open](#)

**Mob:**

**07901181592**

## FINALIZOHET MARRËVESHJA, TË DËNUARIT NË BRITANINË E MADHE TRANSFEROHEN NË SHQIPËRI ULSI MANJA NËNSHKRUAN MARRËVESHJEN NË ANGLI

Shqiptarët e dënuar në Britaninë e Madhe do të transferohen në atdhe. Ministri i Drejtësisë Ulsi Manja, ka zyrtarizuar këtë të mërkurë me homologun britanik Alex Chalk, fillimin e implementimit të marrëveshjes për transferimin e shtetasve shqiptarë të dënuar nga Britania e Madhe për në Shqipëri, përfshirë edhe të dënuarit me burgim të përjetshëm.

Kjo marrëveshje përfaqëson vullnetin politik ndërmjet dy qeverive dhe thellimin e bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve mike dhe aleate në NATO.

Qëllimi kryesor i marrëveshjes është rehabilitimi social i të dënuarve shqiptarë në Britani, duke i krijuar mundësinë e vuajtjes së pjesës së mbetur të dënimit në atdhe, pranë nënave, fëmijëve, bashkëshorteve dhe familjeve të tyre.

Marrëveshja do të jetë me 0 kosto financiare për shtetin shqiptar, pasi pala britanike mbulon shpenzimet për çdo ditë që të dënuarit do të vuajnë në burgjet tona.

Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria e Përgjithshme Burgjeve do të përfitojnë mbështetje logjistike dhe grante, që do të investohen për burgjet shqiptare dhe në fuqizimin e kapaciteteve tona njerëzore.

Për transferimet do të kenë prioritet ata që japin pëlqimin e tyre për t'u kthyer, me përjashtim të rasteve kur në vendimet e gjykatës britanike parashikohet deportimi i tyre nga Mbretëria e Bashkuar.

Në ditët në vijim pala angleze do të sjellë 22 automjete të tipit minibus për transportin e punonjësve të policisë së burgjeve. Ministri i Drejtësisë Ulsi Manja ka takuar disa shqiptarë të dënuar në një nga burgjet angleze.

Manja bisedoi me një grup prej 18 të dënuarish në Pentonville. Të dënuarit shprehën shqetësimet e tyre lidhur me asistencën me përkthimin në gjuhën shqipe, librat shqip, takimet me familjarët dhe respektimi i orëve të ajrimit.

Sipas Manjës, të dënuarit shqiptarë shprehën interes për marrëveshjen e transferimit të tyre për të vuajtur pjesën e mbetur të dënimit në Shqipëri.

“Pas takimit, patëm mundësinë që shqetësimet e tyre t'i bisedonim jo vetëm me autoritetet e burgut në Pen-



tonville, por dhe me Damian Hinds, Ministrin e Shtetit për Burgjet, për ta adresuar trajtimin e tyre në nivel të të gjitha burgjeve në Mbretërinë e Bashkuar.

U dakordësuam për një projekt të shpejtë midis Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe autoriteteve britanike

që menaxhojnë burgjet, për sjelljen e librave në gjuhën shqipe në çdo burg ku aktualisht ka shqiptarë të dënuar dhe të paraburgosur.

Projekti i edukimit dhe rehabilitimit të tyre dhe mundësia për të ruajtur kontaktet me familjet e tyre në Shqipëri do të jetë pjesë e një projekti

në vazhdim, pas zbatimit të marrëveshjes së transferimit”.

Në Pentonville vuajnë dënimin e tyre rreth 60 shqiptarë.

Një ditë më parë, ministri anglez i drejtësisë Alex Chalk dhe ai shqiptar Ulsi Manja firmosën marrëveshjen për transferimin e të burgosurve shqiptarë për vijimin e vuajtjes së dënimit në burgjet shqiptare.

Në marrëveshje parashikohet se çdo ditë burg e të transferuarve nga burgjet britanike do ta paguajë pala angleze. Përlogaritet se në afatin dy vjeçar të kësaj marrëveshje pala britanike do të paguajë 20 milion sterlina.

Parashikohet transferimi i të gjithë atyre shqiptarëve që kanë për të vuajtur më shumë se katër vite burg. Deri më tani, kanë aplikuar për t'u transferuar 48 të burgosur shqiptarë. Parashikohet se me këtë marrëveshje me afat kohor dy vjeçar të transferohen 200 shtetas shqiptarë mes tyre 17 të burgosur me burgime të përjetshme për vrasje.

HA  
HARIS ALI SOLICITORS

## KONSULTIMET FALAS

OFFICE: 020 8570 7300 / MOBILE: 07967 467414

We are **Immigration Experts** who have a high success rate in representing thousands of **Albanian** clients with a variety of immigration issues. We have a highly experienced team of immigration solicitors and barristers.

- Asylum / Trafficking
- Overstayers / Human Rights
- Detention & Bail
- Appeals & Judicial Review
- Fresh Claims / Further Submissions
- Indefinite Leave To Remain / Nationality
- EEA Permits / Stateless / Deprivation
- Spouse Visas / Children's Visas

Email: [contact@harisalisolicitors.co.uk](mailto:contact@harisalisolicitors.co.uk)

19 Kingsley Road, Hounslow, London, TW3 1PA | [www.harisalisolicitors.co.uk](http://www.harisalisolicitors.co.uk)

# LEXMARK LEGAL

EKSPERTËT TUAJ TË BESUAR NË LIGJIN E  
EMIGRACIONIT

## A PO KËRKONI NDIHMË PROFESIONALE PËR ÇËSHTJET E EMIGRACIONIT?

Mos kërkoni më tej! Lexmark Legal është ekipi juaj i kërkuar i avokatëve ekspertë të imigracionit në Londër, të përkushtuar për të ofruar zgjidhje ligjore të nivelit të lartë të përshtatura për nevojat tuaja.



## PSE TË ZGJIDHNI LEXMARK LEGAL?

- Profesionistë me përvojë të imigracionit
- Zgjidhje ligjore të personalizuara
- Ekspertizë e shumëanshme
- Përkushtuar për suksesin tuaj
- Qasje e dhembshur dhe e kujdesshme

Gati për të ndërmarrë hapin e parë drejt zgjidhjes së shqetësimeve tuaja ligjore? Kontaktoni avokatët e imigracionit ligjor të Lexmark dhe na lini të jemi partneri juaj ligjor i besuar.


## CONTACT US

ANA: 07435119343

ALDO: 07494181220

SANTJOLA: 07742877853

OFFICE: 0208 090 2488

 The Winning Box, Aquis House, 27-37 Station Road, Hayes, UB3 4DX

## SHËRBIME TË REJA:

### 1. Mbështetja e Legjislacionit Civil:

Lundrimi përmes legjislacionit civil mund të jetë kompleks, por mos u shqetësoni! Profesionistët tanë të kualifikuar ligjorë janë këtu për t'ju udhëhequr në çështje të ndryshme të së drejtës civile. Nga mosmarrëveshjet e kontratave të drejtat pronësore, ne ju kemi mbuluar me këshilla dhe përfaqësim gjithëpërfshirës.

### 2. Ndihmë e dhembshur për të drejtën e familjes:

Ne i kuptojmë ndjeshmëritë e përfshira në çështjet e së drejtës familjare. Qoftë divorci, kujdestaria e fëmijës ose birësimi, ekipi ynë empatik është i përkushtuar për t'i zgjidhur çështjet familjare me kujdes, duke siguruar rezultatet më të mira të mundshme për ju dhe të dashurit tuaj.

### 3. Shërbime të fuqishme të mbrojtjes kriminale:

Kur përballeni me akuza penale, të kesh një mbrojtje të fortë ligjore është thelbësore. Avokatët tanë me përvojë janë njohës të mirë të ligjit penal dhe të përkushtuar për të mbrojtur të drejtat tuaja. Nga konsultimet ligjore të përfaqësimi në sallën e gjyqit, ne jemi këtu për të luftuar për drejtësinë tuaj.

# VIZA E PUNËS

**ANXHELA SEJDINI**  
*ASHTON ROSS LAW*

**Kategoria e vizes se punes i lejon aplikantet te hyjne ne Mbreterine e Bashkuar dhe te punojne per nje punedhenes te miratuar.**

**Per t'u kualifikuar per kete vize, duhet te plotesoni kerkesat e meposhtme:**

1. Punedhenesi juaj duhet te kete nje licence sponsorizimi.
2. Punedhenesi juaj duhet t'ju ofroje zyrtarisht t'ju punesoj e ne menyre qe te mund te punoni me ta.
3. Puna qe ju ofrohet duhet te jete ne listen e profesioneve te Home Office.
4. Punedhenesi juaj duhet te jete ne gjendje t'ju paguaje pagen perkatese per rolin.
5. Ju duhet te jeni ne gjendje te kaloni testin e njohurise se Anglishtes.

**Nese jeni ne gjendje te plotesoni**

**kriteret e mesiperme, ju mund te kualifikoheni per te aplikuar per nje vize pune.**

**Kjo vize do t'ju lejoje te hyni dhe te qendroni ne Mbreterin e Bashkuar per 5 vjet. Pasi te keni punuar vazhdimisht per 5 vjet ne kete kategori vize, mund te aplikoni per leje qendrimi te pacaktuar dhe me pas per t'u bere shtetas Britanik.**

**Ne qofte se kjo kategori eshte ne interesin e juaj, ju mund te kontaktoni Anxhelen per konsultim ligjore ne numrin 07578931363.**



## PRESIDENTJA OSMANI I SHPREH MIRËNJOHJE TË THELLA DEPUTETES BRITANIKE ALICIA KEARNS

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur të premtën në takim deputeten e Parlamentit të Mbretërisë së Bashkuar, Alicia Kearns, njëherësh kryetare e Komisionit të Punëve të Jashtme të Parlamentit të Mbretërisë së Bashkuar.

Kabineti i Presidentes Osmani bën të ditur se në takim është diskutuar për situatën aktuale në Kosovë, me theks në situatën e sigurisë pas sulmit terrorist të serbëve në pjesën veriore të Kosovës, më 24 shtator, i cili u cilësua si akt i agresionit të Serbisë ndaj Kosovës.

“Presidentja Osmani e ka informuar deputeten britanike me sfidat me të cilat po përballet Kosova dhe ka theksuar rëndësinë e përpjekjeve të unifikuar ndërkombëtare për t’iu kundërvënë akteve të tilla terroriste dhe të agresionit në funksion jo vetëm të sigurisë së qytetarëve të Kosovës, por edhe stabilitetit rajonal e më gjerë”, thuhet në njoftim.

“Në këtë kontekst, Presidentja Osmani ka theksuar se hetimet e deritanishme të kryera nga autoritetet vendore, përderisa vazhdojnë hetimet nga partnerët ndërkombëtarë, dëshmojnë se Serbia qëndron pas sulmit të 24 shtatorit në Banjskë të Zveçanit, ndaj ka kërkuar që të ndërmerren masa ndëshkuese ndaj Serbisë”, thuhet më tutje në njoftim.

Presidentja Osmani ia ka shprehur deputetes Kearns mirënjohjet më të thella të qytetarëve të Kosovës për përkrahjen e jashtëzakonshme për Kosovën, sidomos për paralajmërimin e rreziqeve me të cilat ballafaqohet Kosova, por edhe gjithë rajoni, nga aktet destabilizuese të Serbisë.

“Deputetja Alicia Kearns është një avokuese e shquar për Kosovën, ndaj ne presim që angazhimi i saj të jetë edhe më tutje në funksion të prezantimit të gjendjes reale këtu, duke u mbështetur në argumente e fakte,



ashtu siç bën vazhdimisht ajo”, ka theksuar Presidentja Osmani. Deputetja Kearns, nga ana e saj, e ka falënderuar Presidenten Osmani për ftesën që ta vizitojë Kosovën dhe ka shprehur përkushtimin për të vazhduar mbështetjen e saj personale për Kosovën, si edhe përkushtimin e vendit të saj, Mbretërisë së Bashkuar, për të punuar ngushtë me të gjithë faktorët ndërkombëtarë për paqe, stabilitet dhe prosperitet.

Deputetja e Parlamentit të Mbretërisë së Bashkuar, Alicia Kearns, ka ngritur disa herë shqetësimin lidhur me aktet e dhunës dhe veprimet despabilizuese të Serbisë në Kosovë. Ajo ka ngritur alarmin për përfshirjen e klerit ortodoks serb në Kosovë në qëllimet subversive të Serbisë në Kosovë.

Zonja Kearns ka paralajmëruar se

grupet terroriste serbe, prapa të cilave qëndron Beogradi zyrtar, po depozitonin armë në kishat dhe manastiret ortodokse serbe në Kosovë, sidomos në pjesën veriore të Kosovës, të cilat do t’i përdornin për aneksimin e territoreve të Kosovës. Këtë paralajmërim ajo e ka përsëritur disa herë, para sulmit terrorist serb në Banjskë, më 24 shtator.

Misioni i Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit në Kosovë, EULEX, i kontestoi paralajmërimet e zonjës Kearns. Por, ato u dëshmuar pas sulmit në Banjskë. Në ambientet e Manastirit të Basnjskës, ku u barrikaduan pjesëtarët e grupit paramilitar serb, u gjetën dhe konfiskuan sasi të mëdha armësh më moderne të kalibrave të ndryshme, mjetesh e lëndësh shpërthyeshe dhe pajisjesh luftarake.

Alicia Kearns e ka kritikuar

Bashkimin Evropian për qëndrimin e ashpër ndaj Kosovës dhe për “përkëdheljen” e Serbisë.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, e ka përsëritur gjatë një takimi me deputeten britanike Alicia Kearns të dielën se Serbia duhet të ndëshkohet për sulmin e muajit të kaluar në veri të Kosovës “në mënyrë që të mos e përsërit atë më”.

Në një njoftim për media të dielën, Qeveria e Kosovës tha se në takim mes Kurtit dhe Kearnsit “u theksua që prioritet kryesor për Republikën e Kosovës është siguria e shtetit dhe e qytetarëve”.

“Pas sulmit terrorist dhe kriminal të 24 shtatorit të kryer nga grupe paramilitare me sponsorim dhe pjesëmarrje të Serbisë, ndëshkimi është vendimtar për mospërsëritje”, tha Kurti.

Rreth dy muaj para sulmit ndaj Poli-

cisë së Kosovës nga një grup serbësh të armatosur në Banjskë të Zveçanit më 24 shtator – ku mbeti i vrarë rreshteri Afrim Bunjaku – Kearns kishte thënë se “armët po kontrabandohej në autoambulanca dhe më pas po ruhen në objektet e kishave”.

Policia e Kosovës ka gjetur arsenal të jashtëzakonshëm armësh në veri pas sulmit, për të cilat tha se janë futur në Kosovë përmes Serbisë.

Kosova e ka akuzuar Serbinë se tentoi ta “aneksojë tërë veriun e Kosovës”, gjë të cilën Serbia e ka mohuar, megjithëse përgjegjësia për sulmin e mori Millan Radoiqiq, nënkryetari i atëhershëm i Listës Serbe, partisë më të madhe të serbëve në Kosovë që ka mbështetjen e Beogradit.

Kurti, sipas njoftimit të Qeverisë, shprehu edhe “përkushtimin e plotë” për zbatimin e Marrëveshjes Bazë dhe aneksit të zbatimit të saj, që Kosova dhe Serbia i arritën në fillim të këtij viti.

Takimi i Kurtit me Kearns vjen vetëm një ditë pasi lideri kosovar i priti emisarët perëndimorë në Prishtinë të shtunën.

Emisarët perëndimorë i kërkuan Prishtinës dhe Beogradit gjatë takimeve të së shtunës me Kurtin në Prishtinë, dhe presidentin serb Aleksandar Vuçiq në Beograd, që t’i normalizojnë marrëdhëniet dhe ta zbatojnë Marrëveshjen drejt normalizimit.

Kearns, ndërkohë, qëndroi në Kosovë këtë fundjavë me ftesë të presidentes së Kosovës, Vjosa Osmani, me të cilën u takua dje. Ajo u prit edhe nga kryeparlamentari i Kosovës, Glauk Konjufca.

(REL)



ASHTON ROSS LAW

# EMIGRACIONI

Çdo çështje është unike dhe për kete arsye ne kemi krijuar një reputacion për ofrimin e këshillave dhe shërbimeve të emigracionit më të shkëlqyer.

Ne kemi një shkallë të lartë suksesi në çështjet që marrim përsipër. Llojet e çështjeve që marrim përsipër janë:

- Immigration Appeals
- Judicial Review
- Administrative Review – rishqyrtim vendimi
- British Citizenship deprivation
- Indefinite Leave to Remain
- Family and Dependant related visa applications for children, spouses and fiancés
- Dependant visa

**CALL NOW**

T: 075 7893 1363

1 Quality Court, London,  
WC2A 1HR

[www.ashtonrosslaw.com](http://www.ashtonrosslaw.com)



Për çdo pyetje në lidhje me emigracionin, kontaktoni Anxhelën në numrin e telefonit: 07578931363.

## HUMAN RIGHTS

- EU Settlement Scheme
- Detention & Bail
- Private and Family life
- Naturalisation
- Asylum
- Visa Extensions
- Sponsorship licence
- Switching Visas

## Çështje familjare

- Divorce
- Adoption
- Child Arrangement Orders
- Parental Responsibility
- Orders
- Premarital agreements
- Postmarital agreements






DAUT DAUTI

Këto dokumente janë nga Arkivi Kombëtar Britanik, që janë korrespondencë diplomatike e Foreign Office-it, flasin për qeverinë e parë të Palestinës të formuar në vitin 1948.

Kryeministër, siç shihet edhe në këto dokumente, ka qenë Ahmet Hilmi Pasha (1884-1963), një shqiptar i lindur në Sidon apo Saida të Libanit. Pasi që ishte shqiptar, arabët e quanin Ahmed Al Arnauti.

Hilmi Pasha ka qenë një lloj gjeniu në financë, por edhe në politikë dhe ushtri. Në Perandorinë Otomane ka shërbyer disa herë si ministër i financave dhe si ushtarak kishte gradën e gjeneralit. Pas rënies së Perandorisë Otomane, ai shërbeu si ministër dhe këshilltar i financave në disa vende arabe dhe është themelues i bankave të para arabe.

## KRYEMINISTRI I QEVERISË SË PARË TË PALESTINËS KA QENË SHQIPTAR



1. AHMAD HILMI PASHA was born in 1884. He is of Albanian origin and served as a Turkish finance official until 1916. He was Finance Minister to King Feisal during the latter's short period of rule in Syria, from whence he was exiled by the French owing to his association with extreme Arab political movements. He served in Amman from 1922-24 as Finance Minister. He had to leave both Transjordan and Palestine owing to his political activities as a member of the Istiqlal party. Later he was permitted to re-enter Palestine as result of the intercession of the Mufti. He and his son-in-law Abdul Hamid Shuman founded the Arab Bank, but, later on falling out with his partner, he established in 1933 the Arab National Bank, of which he is the present chairman. He also was responsible in 1935 for the renaissance of the "People's Fund", which had as its aim the buying up of arab land which might otherwise have fallen into Jewish hands. His efforts met with only moderate success. Various plans to amalgamate the fund with the Beit al-Mal, the fund administered by the Mufti, have never materialised. Having achieved a prominent position among the Palestinian Arabs through his financial influence, he was appointed a member of the first Arab Higher Committee. He was deported with other members of the Committee to the Seychelles, from whence he was permitted to return to Palestine in 1940. He was elected to the second Arab Higher Committee formed in November, 1945. Recognising the potential strength of the Jews, he aimed at procuring unity among the Palestine Arabs, and favoured the launching of a revolution before the termination of the Mandatory Government. However a friend of the Husseini faction, he has latterly shown himself as opposed to the Mufti. After the termination of the Mandate he was the only member of the Arab Higher Committee left in Jerusalem, of which he has apparently become the Arab Military Governor.

ishin të krishterë. Qeveria e Hilmi Pashës ka funksionuar disa vite, por ra nën hije dhe u bë e parëndësishme pasi që Amerika dhe disa vende evropiane kishin tjera plane, të cilat po shihen edhe sot.

Pasi që gëzonte popullaritet të madh dhe pasi që kishte ndihmën e dinastisë shqiptare të Egjiptit, Hilmi Pasha u zgjodh kryeministër i qeverisë palestineze. Kjo qeveri, me seli në Gaza, kishte 8 ministra arabë të Palestinës, dy nga të cilët

### Apollonia Transport

**TRANSPORT MALLRASH**  
**ANGLI - SHQIPERI**  
**SHQIPERI - ANGLI**

**SHQIPËRI**

Tiranë - Durres-Elbasan-Berat  
Fier-Vlorë-Roskovec-Ballsh

**BRITANI**

Londër - Birmingham  
Manchester - Leeds - Luton

**NA KONTAKTONI**

📞 UK: 00447429200952  
📞 AL: 00355682948843  
📞 AL: 00355694031009

### TRANSPORT SHQIPERI - ANGLI

**+44 7741 588799**

**+355 67 728 2828**

**SHQIPËRI**

- Elbasan
- Tirane
- Shkoder
- Lezhe
- Laç
- Fushe Krujë
- Lushnjë
- Berat
- Poshnjë
- Belsh

**ANGLI**

- Londër
- Manchester
- Sheffield
- Leeds
- Birmingham
- Coventry
- Luton
- Oxford
- Northampton

Ju Faleminderit qe na besoni!

**Për oferta speciale ju lutem na kontaktoni në çdo kohë**



**NESE JU DUHET NJE DOKTOR  
MOS HEZITONI TE VIZITONI  
VAL CLINIC**

**THE BEST MEDICAL CENTER**

**OUR SERVICES:**

**CARDIOLOGY  
ENT  
PAEDIATRICS  
GYNAECOLOGY  
DERMATOLOGY  
INTERNAL MEDICINE  
RADIOLOGY  
PHYSIOTHERAPY  
NEUROLOGY  
SURGERY AND MINOR INJURY  
UROLOGY  
ENDOCRINOLOGY  
GASTROENTEROLOGY  
AESTHETIC MEDICINE  
PODIATRY  
FULL CHECK-UP  
PSYCHOLOGY  
PSYCHIATRY  
DIAGNOSTICS:  
ALL TYPE OF BLOOD TEST  
AND SWABS AFTER  
DOCTORS  
CONSULTATION**



**PERSHENDETJE,  
JAM DR. ARJOLA DHE PUNOJ  
NË VAL CLINIC QË ËSHTË NJË  
KLINIKË NË LONDËR ME  
MJEK/E SPECIALISTË TË  
GJITHË SHERBIMEVE  
MJEKESORE. PËR ÇDO  
PROBLEM NA KONTAKTONI**

**NA KONTAKTONI**



**INFO@VALCLINIC.CO.UK  
WWW.VALCLINIC.CO.UK**

**39 Frederick Road  
Rainham RM13 8NJ  
Tel: 01708701155  
Mob: 07307595437**

IRENA BEQIRAJ

# DUHEN MODELE TË REJA POLITIKE DHE SHOQËRORE, SPAK NUK NA E GARANTON DREJTËSINË DHE DEMOKRACINË

Jean-Jacques Rousseau shkruante "Ata që dëshirojnë të trajtojnë politiken dhe moralin veçmas, nuk do të kuptojnë kurrë asgjë nga asnjëra."

Politika jo vetëm duhet por edhe mund të pajtohet pikë së pari me imperativat e ndershmërisë edhe moralit. Nëse kjo nuk ndodh, demokracia edhe drejtësia janë realitete imagjinare vetëm në kokat e atyre që flasin për to.

Kur ne pranojmë se politikanët nuk mund të jenë asgjë tjetër veçse të pandershëm, dhe si të tillë neve na mbetet vetëm të zgjidhim dilemën e gjetjes së të keqes më të vogël, duke e kërkuar ta shquajmë qartazi atë tek të njëjtët njerëz të pazëvendueshëm, edhe ketë ta quajmë arritje demokratike apo mbrojtje të parimeve demokratike jemi larg të qenit të ndershëm edhe më afër të qenit fanatik.

Në 1993, u arrestua Lideri i opozitës Fatos Nano. Nëse do të ridëgjoni sot debatet e 27 viteve më parë esenca është e njëjtë, disa thonin që "Nano po denohej politikisht nga Berisha", ndërsa pjesa tjetër thonin "se kishte shkelur ligjin".

Qëndrimet edhe gjykimet fanatike të opinionit publik të asaj kohe të verbuar nga bindja e të drejtës absolute në të gjitha rastet në mbrojtje të parimeve, nuk ofruan paanshmëri. Fa-

natikët e kauzave të tyre janë të papërkulur dhe inercial, rula me avull të gatshëm të rrafshojë gjithçka në rrugën e tyr.

Ishin pikerisht qëndrime fanatike që nuk na lejuan të kuptonim asnjëherë se nga cila anë qëndronte pandeshmëria politike nga Nano apo Berisha, apo të dy ishin të pandershëm? Prandaj të dy të pazuar u rehabilituan edhe me votat e publikut u ricikluan në pushtet, Nano në 98 edhe Berisha në 2005.

Pra ku qëndronte opinioni publik? Nga anonte qëndrimi ynë i ndershëm? Ndonjë socialist që lexon këto rreshta thotë "prit një minutë Berisha është kriminel edhe do të rreshtojë dëmet e tij, "E ndërsa ndonjë demokrat thotë "si mund të krahasohen, Nano ishte një njeri plot me vese edhe super i korruptuar apo hajdut". Në të dy rastet mendohej të masim e ti dënojmë në bazë të dëmit, pa dënuar së pari pikën ku ato bashkoheshin "pandershmerinë e tyre të përsëritur politike".

Ata riciklohen sepse ne shpesh ngatërrojmë parimet morale me sentimentin, edhe shumë qëndrime të debatuesve më të angaxhuar publik i



gjej fatkeqësisht sentimentale, më shumë sesa parimore edhe morale.

Prsh, unë nuk jam juriste, por më bën sens arsyetimi i juristeve që masa e sigurisë ndaj deputetit pa autorizimin e Kuvendit është në shkelje të nenit 73 të Kushtetutës.

Fakti që kjo ndodhi, ka hedhur një hije dyshimi të fortë mbi drejtësinë e re.

Por kjo nuk me pengon të vërej një

paradoks tjetër.

Në 2012 kur ishte në pushtet lideri i opozitës këkonte heqjen e kësaj mbrojtjeje, duke argumentuar me të drejtë që deputetët nuk duhet të kishin imunitet edhe të ishin si gjithë qytetarët të barabartë para ligjit edhe drejtësisë, që duhet pranuar që asaj kohe nuk ishte më pak politike nga kjo e sotmja. Ndërsa sot ai kishte një mundësi për të treguar se

ishte i vërtetë në qëndrimin e tij argumenti politik për shkeljen e të drejtave të tij po ngrihet mbi shkeljen e po asaj të drejte kushtetuese që ai mendonte edhe besonte që deputetët s'duhet ta kishin.

Në fakt, kur kritika edhe dëshira për të ekspozuar dhe publikuar një problem, janë shumë më të mëdha se gatishmëria për ta venë ate jetë qoftë edhe në një rast të vetëm është forma

më e zakonshme e pandershmërisë në politikë.

Edhe në këtë formë pandershmërie janë të zytur gjithë liderat tanë pa përjashtim.

Unë si shumë nga ju mendoj që Rama nuk duhet të jetë më asnjë minutë në pushtet edhe madje as në krye të Partisë Socialiste, pikë së pari për mungesë të moralit politik pastaj të dëmeve të shkaktuara gjatë ushtrimit e pushtetit.

Por a mund të presim që SPAKU të rrezojë Ramën, apo modelin e tij që mishërohet tek shumë të tjerë? Jo.

Kur shoqëria shfaqet kaq sentimentalisht e ndjeshme ndaj mosrespektimit të ligjeve, por vazhdon të anashkalojmë edhe të mos vlersojmë mungesën e moralit edhe ndershmërisë si themeli bazë i të drejtës shoqërore, i ndershmi sic ka ndodhur do të përkulet para ryshfetarit kështu gjyqtari kur më nuk mund, bëhet ortaku i zuzarit.

E pra pa u distancuar nga modelet e pandershme politike e shoqërore pa artikulluar qartazi nevojën për modelet të reja nuk ka SPAK e ligj që do të na garantojë drejtësinë e aq më shumë demokracinë.

## DITI TRANSPORT

ANGLI-SHQIPERI-ANGLI

Shërbim korrekt  
Çmime konkurruese



FALEMINDERIT MIJËRA KLIENTËVE QË NA BESOJNË PREJ VITSH



NA KONTAKTONI



0035569 216 5221

0035569 861 5790



0044779 611 1539

0044744 484 5606

GRUMBULLIMI  
NË ANGLI

✓ SHEFIELD

✓ LUTON

✓ LEICESTER

✓ WIMBELDON

✓ HOUNSLOW

GRUMBULLIMI  
NË SHQIPËRI

✓ TIRANË

✓ ELBASAN

✓ BELSH

✓ BERAT

✓ DURRES

✓ HAS

✓ KUKES

✓ RRESHEN

✓ LEZHE

✓ SHKODER

# ANALIZA E REL: KËRKESA “MERRI OSE LËRI” PËR KOSOVËN DHE SERBINË

**Për përmbajtjen e tyre ka pak informacione, por thuhet se i obligojnë palët për disa hapa që do të çonin në normalizimin e marrëdhënieve mes tyre.**

Kërkesat dhe propozimet që pesë emisarët perëndimorë kanë nxjerrë para Kosovës dhe Serbisë, janë të prera për të dyja vendet, vlerësojnë njohësit e zhvillimeve politike në Prishtinë dhe Beograd. Për përmbajtjen e tyre ka pak informacione, por thuhet se i obligojnë palët për disa hapa që do të çonin në normalizimin e marrëdhënieve mes tyre.

Udhëheqësit e Kosovës dhe të Serbisë u takuan për herë të fundit më 14 shtator. Dhjetë ditë më pas ndodhi sulmi në Banjskë, ku grupe të armatosura sulmuam policinë e Kosovës, duke vrrarë një rreshter. Kosova bëri përgjegjëse Serbinë për këtë sulm, Serbia tha se ai është kryer nga një “grup i serbëve të dëshpëruar lokalë”.

Në përpjekje për t'i kthyer palët në tryezën e bisedimeve, diplomatë nga Bashkimi Evropian, Shtetet e Bashkuara, Franca, Gjermania dhe Italia qëndruan më 21 tetor në Prishtinë dhe në Beograd, ku paraqitën kërkesat e tyre.

Qeveria e Kosovës nuk iu përgjigj pyetjeve të Radios Evropa e Lirë se cilat janë ato dhe si do të përgjigjet Kosova ndaj tyre.

Sipas analistëve Agon Maliqi dhe Dushan Janjiq, ato kanë të bëjnë me një hartë të rrugës që duhet ndjekur për zbatimin e Marrëveshjes drejt normalizimit të marrëdhënieve Kosovë-Serbi, të arritur në muajin shkurt në Bruksel.

Burimet diplomatike evropiane i thanë Radios Evropa e Lirë se kërkesat për Kosovën kanë të bëjnë me pranimin e një drafti për themelimin e Asociacionit të komunave me shumicë serbe, ndërsa ato për Serbinë me respektimin pa kushte të obligimeve që dalin nga Marrëveshja për normalizim.

Njohësi i zhvillimeve politike në Kosovë, Agon Maliqi, thotë se nga ajo që është kuptuar deri më tash, në planin e pesë emisarëve perëndimorë përfshihet çështja e formimit të Asociacionit të komunave me shumicë serbe, si dhe hapat për zbatimin e Marrëveshjes drejt normalizimit të marrëdhënieve Kosovë-Serbi.

“Me gjasë [emisarët perëndimorë] kanë ardhur me një ultimatum mbi sekuençën dhe hapat se si do të shkohet deri te zbatimi [i marrëveshjes]. Propozimi, me gjasë, nuk është i hapur për komentet e palëve, por më shumë është si dokument ose si një sekuençë e formës ‘pranoje ose lere’”. Kjo duket qartë, për shkak se afatet



kohore për fillimin e zbatimit të marrëveshjes, po harxhohen”, thotë Maliqi për Radion Evropa e Lirë.

Sipas tij, fakti që ekzistojnë pritje që liderët e Kosovës dhe Serbisë të takohen sa më shpejt, tregon që vendet e QUINT-it - SHBA-ja, Franca, Gjermania, Britania e Madhe, Italia - kërkojnë përgjigje të shpejtë dhe hapa të shpejtë nga të dyja palët. Maliqi thotë se kërkesat e ndërkom-bëtarëve me siguri që nuk lënë anash as sulmin e 24 shtatorit në Banjskë.

“Në lidhje me zhvillimet në veri, gjithsesi duhet të ketë dhe besoj se do të ketë [kërkesa nga emisarët perëndimorë], qoftë në formën e kushtëzimeve për Serbinë në rrugën e saj integruese, apo edhe ndonjë propozim konkret se çka pritet prej Serbisë në kuptimin e marrjes së masave ndaj grupit [të armatosur]. Kjo besoj se është shumë e nevojshme që të krijohet një lloj fryme e parandalimit të çfarëdo përpjekjeje të ardhshme për destabilizim”, thotë Maliqi.

Pranimi i kërkesave të emisarëve perëndimorë, sipas tij, do të varet nga pasojat që po këta emisarë do t'ua komunikojnë palëve, në rast se nuk i pranojnë ato.

Dushan Janjiq, nga Forumi për Marrëdhënie etnike në Beograd, vlerëson se BE-ja dhe emisarët perëndimorë,

në esencë, po përpiqen të mbajnë një lloj dinamike sa u përket çështjeve politike në kuadër të dialogut Kosovë-Serbi.

Por, shton ai, para cilësdo çështje politike, ata kërkojnë ta definojnë gjendjen e sigurisë në veri të Kosovës.

Janjiq vlerëson se sulmi në Banjskë, është çështja e parë që trajtohet në kërkesat e emisarëve perëndimorë.

Kjo situatë, sipas tij, paraqet problem serioz për presidentin serb, Aleksandar Vuçiq.

“Nuk i japin hapësirë [Vuçiqit] të lëvizë jashtë kësaj çështjeje të sigurisë, derisa të mos fillojë gjykimi [ndaj grupit të armatosur] dhe derisa të mos zgjidhet çështja e kthimit [të serbëve të veriut] në institucione. Kjo është e re, sepse, për herë të parë, ata janë në prag të bisedimeve për pakon e sigurisë, e cila, sipas definicionit, nuk funksionon në formatin ku [i dërguari i BE-së për dialogun, Miroslav] Lajçak dhe [shefi i politikës së jashtme të BE-së, Josep] Borrell janë kryesorët. Këtë do ta mbikëqyrë grupi i QUINT-it”, thotë Janjiq për Radion Evropa e Lirë.

Sipas tij, deklaratat e Vuçiqit se vendet e Perëndimit i kanë politikën e veta që “janë plotësisht të kundërta”

me qëndrimin e Serbisë, janë për “konsum të brendshëm”.

Janjiq thotë se Vuçiq është pajtuar tashmë me Aneksin e zbatimit të Marrëveshjes drejt normalizimit të marrëdhënieve Kosovë-Serbi, për të cilin është rënë dakord në Ohër.

“Ai [Vuçiq] e ka pranuar në shkurt atë marrëveshje, ku statusi [i Kosovës] është i zgjidhur, pra pranimi i ekzistencës së Republikës së Kosovës dhe të tjerat. Kështu po bëhet përpjekje që të ruhet ai niveli politik [i dialogut], por se, në esencë, insistohet në siguri. Për të do të marrë mbikëqyrje më të madhe EULEX-i [Misioni i BE-së për sundimin e ligjit]”, thotë Janjiq.

Ai thekson se, pa stabilizimin e situatës së sigurisë në veri, nuk mund të ketë dialog për zbatimin në terren të obligimeve që dalin nga Marrëveshja drejt normalizimit të marrëdhënieve. Në një komunikatë të lëshuar nga Qeveria së Kosovës u tha se “të pesë emisarët ofruan planin e tyre të ri për ecjen përpara, për çfarë kryeministri shprehu falënderimet dhe vlerësimet e tij”.

Aty nuk u dhanë detaje se për çfarë plani bëhet fjalë. Por, sipas komunikatës, Kurti tha se prioritet kryesor dhe çështje urgjente për Kosovën është siguria e shtetit dhe e qytetarëve, e kufijve dhe e territorit. Në

Beograd, Vuçiq tha se takimi ishte “i vështirë”, por se nuk mund të japë më shumë hollësi.

Ai tha se “qëllimi i vetëm” i Perëndimit është njohja e pavarësisë së Kosovës nga Serbia dhe se pret që dialogu Prishtinë-Beograd të vazhdojë kah fundi i kësaj jave.

Kurti edhe Vuçiq pritet të jenë në Bruksel këtë të enjte, kur mbahet një samit i Këshillit Evropian. Sipas burimeve të BE-së, afati i tyre për t'u deklaruar për kërkesat e emisarëve, “nuk është i gjatë” - “më së largu deri të enjten”. Në rast se do të ketë përparim nga ta, atëherë në konkluzat e samitit të BE-së pritet të përfshihet një porosi për Kosovën dhe Serbinë dhe për procesin e dialogut, thonë burimet e BE-së.

SHBA-ja, po ashtu, përsëriti thirrjet për Kosovën dhe Serbinë që t'i kthehen dialogut për normalizimin e marrëdhënieve. Në një mbledhje të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, që u mbajt të hënën, përfaqësuesi i Shteteve të Bashkuara, Robert Wood, tha se “është e rëndësishme që palët të bëjnë përparim në të gjitha marrëveshjet e arritura në dialog”. Ai, gjithashtu, tha se personat e përfshirë në sulmin në Banjskë, duhet të mbahen përgjegjës. REL

BEN BLUSHI

# PSE FITON KOMBËTARJA E SHQIPËRISË?

Shqiptarët luajnë futboll prej gati 100 vitesh, por asnjëherë ata nuk kanë fituar kaq shpesh dhe kaq lehtësisht, si kohët e fundit. Lojtarë të mëdhenj, ndoshta edhe më të mëdhenj se këta që luajnë sot, Shqipëria ka patur disa, por ekip të madh, nuk ka patur asnjëherë.

Futbolli i ditëve tona nuk është vetëm sport. Historia nuk njihet ekip të madh që ka fituar, kur vendi që përfaqëson është i izoluar, është i pushuar apo vuan nga krizat. Nëse 11 lojtarët e Shqipërisë do kishin luajtur për Afganistanin që është një vend anormal, nuk do kishin fituar dot kaq shumë. Nëse të njëjtët lojtarë do kishin veshur bluzat e Ukrainës, ndërkohë që baballarët dhe vëllezërit gjakosen në luftë, nuk do kishin shkuar dot në Kampionatin Evropian.

Zakonisht Kombëtares vrapojnë me hapin e kombit. Historia e futbollit provon se ajo që ndodh jashtë fushës ndikon shumë në fushë. Arsyet jospportive janë po aq të rëndësishme sa arsyet sportive për të fituar. Po kush janë këto arsye në rastin e Kombëtares së Shqipërisë?

Në vitet 50' deri në vitet 90', kur Shqipëria ishte një vend i mbyllur, sportistët, si të gjithë shqiptarët kishin kompleks ndaj të huajve. Kufizimet në ushqim, veshje, teknologji, art, në lëvizje si dhe ndalimet e pronës private dhe fjalës së lirë i detyronin shqiptarët të ishin inferiorë në përgjithësi. Cdo shqiptar besonte se cdo i huaj ishte më i lirë, më i ushqyer, më i fortë, më i shpejtë, më inteligjent dhe më i pasur se ai. Me këtë mentalitet hynin në fushë edhe futbollistët e atyre viteve. Ata luanin të bindur se do mundeshin. Ata ishin të burgosur brenda fanellës që mbronin. Ajo fanellë nuk u kujtonte kombin që donin, por shtetin që nuk donin. Ai shtet u kishte ndaluar cdo gjë të cilën kundërshtarët e tyre e



kishin. Kur ata dilnin jashtë, hutoheshin, sepse vendi i tyre ishte një ferr në krahasim me vendet ku shkolin për të luajtur. Dalja jashtë këtij ferri ishte traumatike dhe u bënte më keq, se mirë. Nëse në fushë ishin të barabartë me futbollistët e huaj, jashtë fushës ishin fatalisht të pabarabartë.

Sot natyrisht është ndryshe. Shqiptarët i kanë kapërcyer kompleksat e izolimit. Më shumë se 1 milion jetojnë jashtë dhe pavarësisht nga punët që bëjnë, janë të barabartë me ata të huaj që bëjnë të njëjtën punë. Në Shqipëri vijnë të paktën 5 milion të huaj që ushqehen, vishen dhe jetojnë si ne. Nëpër lokale janë të barabartë, në hotele janë të barabartë, në konsum janë të barabartë, në gjuhë janë të barabartë, në mëkatë dhe inate janë të barabartë. Barazia jashtë stadiumit ndihmon stadiumin.

Shqipëria sot është në përgjithësi një vend normal. Ajo është shumë më e hapur se Shqipëria e viteve 80, më e kamur se Shqipëria e viteve 90 dhe më e qetë se Shqipëria e viteve 2000. Duke u pasuruar shqiptarët kanë mësuar si të bëjnë më pak dëm vetes. Në mes të viteve 90' ne kishim një Kombëtare të mirë e cila fatqësisht

mundej gjithmonë në minutën e fundit. Aq e shpeshtë u bë kjo rastësi, sa që u kthye në rregull. Dhe meqë u kthye në rregull përsëritej. Ne mundeshim gjithmonë edhe kur shënonim të parët. Lojtarët nuk besonin se mund të fitonin edhe kur ishin në avantazh, prandaj e lëshonin lojën në fund sikur iu humbte durimi.

Por jashtë stadiumit edhe Shqipërisë së atyre viteve i kishte sosur durimi. Megjithëse e hapur ndaj botës, Shqipëria që doli nga komunizmi ishte shumë e varfër dhe shumë e egër. Kombëtarja ishte një mix futbollistësh që kishin ikur si emigrantë dhe kur ktheheshin këtu, gjenin një vend të tmerrshëm, të ashpër dhe të ndarë në copa nga viti 1997. Kush mund tu kërkonte atyre të qëndronin në fushë kur gjithë vendi po binte sic edhe ra? Prandaj Kombëtarja vetëm mundej edhe kur fitonte.

Si rregull, kur vendet vuajnë, Kombëtares mundën sepse humori i vendit ndikon tek lojtarët dhe gjithë ambjenti sportiv. Kombëtarja e Spanjës doli kampione e Botës atëherë kur Spanja arriti zhvillimin më të madh ekonomik në Evropë, në vitin 2010. Suksesi i saj nuk ishte vetëm sportiv.

Gjermania doli kampione e Botës në 2014, kur udhëhiqte gjithë botën me eksportet e saj dhe teknologji. Më parë kishte dalë kampione në vitin 1974 dhe 1990 kur e kishte marrë veten nga rrënimi i luftës dhe ishte kthyer në një superfuqi. Sot Gjermania e ngathët dhe e futur në recesion nuk do dilte dot kurrë Kampione e Botës edhe nëse do kishte marrë borxh 11 lojtarë luftarakë shqiptarë. Njëlloj ka ndodhur edhe me Francën, Italinë, Kroacinë, Greqinë apo Kombëtare të tjera më të vogla. Kur vendet janë mirë, me shëndet ekonomik dhe optimizëm, kombëtares shkëlqejnë.

Por në rastin e Kombëtares sonë ka edhe një arsye tjetër, të ndryshme nga rregullat që ndikojnë te Kombëtares të tjera.

Në historinë e Botës nuk ka asnjë Kombëtare që furnizohet nga tre shtete fqinje si kjo Kombëtare që furnizohet njëkohësisht nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia. Kjo që nuk ndodh askund, ndodh në Shqipëri. Prandaj kjo është një kombëtare e cuditshme si përbërje, e panjohur si rast dhe unike si eksperiment. Kombëtares e mëdha të botës kanë futbollistë nga ish kolonitë e tyre apo nga emigrantët që janë natyralizuar. Por ama një belg që flet frengjisht nuk luan për Francën sepse ai nuk kërkon që Belgjika të bashkohet me Francën, një austriak nuk luan për Gjermaninë sepse asnjë nga këto dy vende nuk do që Austria të jetë Gjermani dhe asnjë argjentinas nuk luan për Spanjën sepse këto janë dy vende të ndryshme që flasin të njëjtën gjuhë.

Ndërsa Kombëtarja e Shqipërisë është unike në planet sepse luan për një shpëtim historik. Tifozët kërkojnë nga ajo të bëjë drejtësi historike duke i mundur armiqtë në fushë. Kombëtarja është një ushtri e vogël shqiptarësh të bashkuar në një qëllim : të korrigjojë historinë duke vrapuar pas një topi.

Ajo bashkon në fushë copat e një vendi të ndarë para 100 vitesh. Prandaj mbledh kaq shumë pasion, nerv, djersë, gjak, lot, energji, demografi, skenografi, koreografi, arkitekturë patriotike dhe epsh për revansh kombëtar. Ajo është e vetmja kombëtare që ka për himn, këngë për njerëz që janë vvarë 30 vjet më parë duke luftuar me armë për ndryshimin e historisë. Këto këngë që vijnë nga lufta dhe ndoshta shkojë drejt luftës, njihen më mirë, këndohen më shumë dhe eksitojnë më fort se vetë himni i Shqipërisë.

Sepse Kombëtarja nuk është vetëm e Shqipërisë.

Kjo është arsyeja që mijëra tifozë kosovarë e braktisin kombëtaren e tyre që përfaqëson një shtet dhe ndjekin kombëtaren e Shqipërisë që përfaqëson një komb. Kombëtarja e Shqipërisë është në fakt Kombëtarja e tre shteteve, ose më saktë kombëtarja që mund të shkatërrojë dy shtetet ku shqiptarët nuk do donin të ishin. Kosovën dhe Maqedoninë. Patriotizmi, pra nevoja për një shtet të përbashkët, është trajneri kryesor i Kombëtares. Ai e drejton, e zbut, e ngut, e ngre, e bashkon, e ndërson, e zmadhon, e harbon, e tërbon, e shkul, e ul, e ngul, e sul dhe e vërsul. Kombëtarja luan dhe fiton në një fushë jeshile që shqiptarëve u duket gjithmonë e kuqe. Bashkimi është fusha e saj. Kundërshtarët janë armiqtë e saj. Topi është arma e saj. Përbërja është shpirti i saj. Nëse Kombëtarja do kishte vetëm futbollistë nga Shqipëria ajo nuk do kishte patur kurrë këtë sukses dhe këtë përkrahje. Shqipëria do kishte një ekip por jo një Kombëtare, por historia kërkon që shqiptarët të kenë dhe ekip dhe Kombëtare.

Kjo është arsyeja që Kombëtarja fiton dhe do fitojë. Edhe nëse ndonjëherë humb. Prapë fiton.

## POROSISNI BANNERIN PER BIZNESIN TUAJ

Jepini diapazonin tuaj

### Te gjitha llojet

- PVC Banners
- Premium Roller Banners
- Pull Up Roller Banners
- Mesh Banners

Adresa e zyrave:  
30 Avenons Road, London, E13 8HT

Na kontaktoni:  
020 7018 7929  
073 4066 5946



## ALFRED LELA

Edi Rama ka gjetur një fabul që, për të mbjtur pushtetin mund ta ndihmojë, por shqiptarëve nuk u bën punë. I përballur me pamundësinë e qeverisjes, kësaj here jo për fajin e opozitës të cilën ka arritur ta marginalizojë-falë një sërë rrethanash vendi i të cilave nuk është këtu për t'u diskutuar-, Kryeministri ka rimarrë si teori qeverisjeje justicializmin. Pra, një qeveri që vendos drejtësinë.

Që në ngjizje ky koncept është malinj dhe antiligjor sepse ngrihet kundër platformës antikushtetuese dhe antidemokratike të ndarjes së pushteteve. E cila përkufizon se ekzekutivi, pra qeveria, nuk mund të ndërhyjë te legjislativi (parlamenti), sistemi i drejtësisë, apo media si pushtet i katërt. Edi Rama, siç e dini, i konsideron të gjitha çështjet e sistemeve të demokracisë si të rrafshit semantik, apo thënë me fjalët e tij, 'kinezëria'.

Si pjesë e këtij justicializmi duhet parë edhe procedimi i Sali Berishës, dhëndërrit të tij, Jamarbër Malltezi dhe një ndërtuesi në Tiranë. Po të shohësh mediat pranë Ramës ato i fryjnë pompës së 'fundit të pandëshkueshmërisë' duke rikrijuar tregimin se të këqijat e Shqipërisë janë të lidhura me Sali Berishën, qeverisjen dhe familjen e tij.

Kjo nuk është gjë e re në zhvillimet politike shqiptare. Në vitin 1944 të njëjtën gjuhë dhe mekanizëm përdorën edhe komunistët me në krye Enver Hoxhën. Edhe atëherë flitej për drejtësi dhe si si duhet t'u tregohet vendi 'klasave te permbysura'.

Si për ta bërë edhe më absurd rik-



thimin e shpagimit majtist, Jamarbër Malltezi është trashëgimtar i një prej familjeve të shpronësuar të pas '44-ës. Madje edhe vetë procedimi aktual lidhet me ato prona që iu morën nga qeveria komuniste. Tani, një qeveri e rilindur komuniste duket sikur kërkon shpagim të dytë. Në të njëjtën kohë e shet këtë si shpagim të popullit për padrejtësitë e duruara nën 'kulakët' si Jamarbër Malltezi dhe 'lehtësuesit' e tij si Sali Berisha.

Jemi në kushtet e një paradoksi perfekt. Pesë familje tiranase, që kanë marrë pronën e tyre të ligjshme në periferi të qytetit janë para togës së pushkatimit nga i njëjti grup shoqëror që pronat private apo publike të

Tiranës dhe Shqipërisë, i ka darovitur sipas më të madhit qejf personal apo klanor.

Shikoni qendrën e Tiranës, atë zonë imobiliare të shumëlakmuar, të përbytur nga një vertikali i kullash që e bën horizontin e qytetit t'i ngjajë një deliri më shumë se një cityline. Kujtoni betejën dhe fundin e dhunshëm të Teatrit Kombëtar dhe mbrojtësve të tij. Ishte një pasuri publike që përfundoi nën skemën 'kullë shumëkatëshe për fitim qeveritaro-privat dhe teatër për popullin dhe propagandën'.

Shihni portin e Durrësit, toka e të cilit iu dha falas një ndërtuesi arab për të

ngritur aty çka Rama me të tijtë kanë të vetmen gjë që dinë të bëjnë: pallate dhe mjedise argëtimi.

Nuk është e panjohur odiseja e pronarëve shqiptarë. Ose u janë rrëmbyer pronat me forcë apo hile nga ndërtuesit e mëdhenj të lidhur me qeverinë, ose i kanë çuar dosjet e tyre në Strasburg ku janë dëmshpërblyer me qindra miliona euro.

Malltezi, bashkë me pronarët e tjerë të tokave ku ndodhej kompleksi Partizani, e kanë nisur përpjekjen e tyre që në vitin 1992. Nëse nuk do ta kishin zgjidhur në mes të viteve 2000, me siguri do t'i ishin drejtuar Strasburgut, dhe me po kaq siguri, çeku që

gjykata europiane do kish urdhëruar qeverinë t'u paguante pronarëve do të kishte qenë më fitimprurës për ta se sa kompleksi i kullave. Në këtë rast tarifën do e paguanin taksapaguesit shqiptarë, jo qeveria. Zgjidhja e pronësisë sipas parimeve të tregut ka qenë rruga e duhur.

Për ata që shqetësohen për pronën publike, që paska qenë kompleksi Partizani si pjesë e nomenklaturës së ushtrisë, të mos përtojnë ta çojnë mendjen dhe sytë në portin e Limionit në Sarandë, ku një oligarku i është dhënë, pa të njëjtën vrasje ndërgjegje që ushtrohet për Partizanin, një pronë e ushtrisë.

Nëse dikush mendon se pozicioni në periferi të Tiranës është më strategjik se një port në gjirin e Sarandës, atëherë...

Shpikja apo rimarrja e justicializmit, i cili kërkon shpagim për padrejtësitë e bëra popullit dhe pronës publike, është një përrallë që e shndërron drejtësinë në mashë të qeverisë dhe lugë bosh për popullin.

Dëshmon gjithashtu, siç e ka bërë ndër shekuj, në këtë vend e në të gjitha vendet, se qeveritë që dështojnë i mbajnë në këmbë popullatat me patericat e iluzionit se të këqijat marrin fund duke goditur një grup shoqëror apo politik.

Ky është justicializmi i Edi Ramës dhe, si ai i Enver Hoxhës, kur t'i bjerë varaku e t'i dallë kallaji do shihet për çka është: një maskë për të mbulur mjerimin qeveritar të personazhit që e krijon.

## YLLI MANJANI

D.m.th me qëllim apo me marmelatë, me plan apo jo u provua plotësisht se reforma në drejtësi u dizenjua për të shkatërruar opozitën.

Ky nuk është më opinion, por fakt. Doni fakte?

1. Lulzim Basha, atëherë kryetar i PD, u vu nën hetim për financim të paqartë në Amerikë. Çështja u mbyll për procedurë. Koha tregoi se çështja u mbyll se Luli pranoi të shesë lojën dhe shkatërrtojë opozitën.

2. Sali Berisha, pas dizenjimit non-grata, i çelet hetim na SPAK me një kallëzim politik të Taulant Ballës. Çështja mbahet për 3 vite nën hetim. Pas 3 vitesh prapë "po hetohet...". Kjo nuk është më ndjekje, por përndjekje penale.

Hetimi vazhdon, megjithëse s'ka prova, sepse Berisha nuk pranoi të shesë lojën. Sidoqoftë goditja ndaj

Tij, veçanërisht me gjyqe popullore, është shkatërrimtare oër opozitën.

3. Ilir Meta është ende nën hetim. Janë të paktën dy episode që raportohen në media se SPAK po heton. Çështja ÇEZ-DIA dhe një financim i paqartë në Amerikë.

Nuk ka lajme, por hetimi është aty. Kur t'i duhet pushtetit, e shpërthen.

E vërteta është që Meta është "qetësuar" disi. LSI u mbyll. PL është thuasë hiç elektoralisht.

4. Fatmir Mediu është nën akuzë tashmë dhe në gjykim. Çështja është e vjetër dhe ligjërisht shumë e sfurcuar.

Sidoqoftë ai është nën akuzë. Pavarësisht rëndësisë elektorale të

## U PROVUA PLOTËSISHT SE REFORMA NË DREJTËSI U DIZENJUA PËR TË SHKATËRRUAR OPOZITËN



PR, dëm është për opozitën në tërësi. Fjala vjen PD e Berishës ishte më komode të garante me siglën e PL së Metës sesa me të PR së Mediut....

Të gjithë këta janë kryetarë partish të opozitës. Kaq parti ka opozita elektorale. Të gjithë të goditur penalisht nga reforma e drejtësisë. Asnjë arres-

tim nga radhët e qeverisë, sado që u bë për show dhe gjithashtu pa prova, nuk ka peshën politike të goditjeve që u është bërë drejtuesve të opozitës.

Ky është fakt.

Ashtu siç është fakt se jo të gjithë e mbajnë presionin. Luli s'e mbajti dot

p.sh...

Nuk po llogaris këtu frymën përçarëse brenda opozitës për shkak të këtyre goditjeve, në dukje penale, por në fakt me karakter politik. Nuk e llogaris në këtë ekuacion sepse përçarjen e kishin në dorë vetë ta shmangin...

Por pasoja është kjo që shohim, opozita drejt shuarjes përfundimtare. Qartësisht, opozita nuk e përballon dot elektoralisht pushtetin absolut. Potenca elektorale e saj ka rënë, pikërisht për shkak të goditjeve penale-politike të drejtuesve të saj.

A ishte ky qëllimi i reformës?!

Nuk e di, por ky është fakti!

# Akoma nuk keni një website?

*The Albanian*

## Akoma nuk jeni regjistruar në Google?

Për çdo konsultim mund te vini në çdo kohë në zyrat tona

Adresa e zyrave: 30 Avenons Road London E13 8HT

 **020 7018 7929**

 **073 4066 5946**

VETON SURROI

Vizita e pesëshes në Prishtinë e shkuarja në Beograd ishin përpjekje për të treguar se vazhdohet më tutje, me një proces seriozisht të dëmtuar 1.

Nuk duhet të ketë qenë ndonjë ndjenjë e bukur që pesë përfaqësues të katër shteteve të mëdha evropiane dhe një amerikan të zbresin në Prishtinë e Beograd brenda ditës, duke treguar kështu tërë seriozitetin e situatës, ndërsa në të njëjtën kohë zhvillohet një tragjedi lufte në Ukrainë dhe një tjetër mes Izraelit dhe palestinezëve.

Aq më pak do të ketë qenë ndjenjë e bukur që të pesë përfaqësuesit të kenë ardhur me tonin e urgjencës, por duke pasur një qasje që i ngjason “business as usual”, ta vazhdojmë aty ku e lamë – ndoshta diku atëherë në mars, ndoshta në maj, ndoshta në qershor a korrik a shtator.

Pesë përfaqësuesit e ardhur në Prishtinë dhe Beograd mund të kenë sjellë një dokument që mund të jetë një draft statuti për Bashkësinë e komunave me shumicë serbe, por këtë dokument e sollën në një proces që është i dëmtuar strukturalisht. Procesi i ngjason një veture së cilës i kanë rënë një a më shumë rrota, por shoferët besojnë se nëse vazhdojnë ngasjen kjo nuk do të hetohet, disi do të arrihet në cak.

2.

Në të kaluarën rrotat mund të kenë pasur emra të tjerë (“dialogu teknik”, eksperimentime me këmbim terri-torësh e të ngjashme), por më 2023 dy rrotat strukturore të veturës janë asimetria dhe Banjaska.

Rrota e cila ka rënë që në fillim të këtij viti ka qenë asimetria e Marrëveshjes bazike. Për Kosovën kjo ka qenë dhe është Marrëveshje obliguese mes Kosovës dhe Serbisë dhe kryeministri ka ofruar që atë ta nënshkruajë. Në fakt, qe menduar që pas miratimit në parim të organizohej një ceremoni nënshkrimi formal (mbase në Paris, dhe kjo do të kishte marrë edhe një dimension të veçantë estetik), por për Serbinë kjo marrëveshje bazike nuk është as Marrëveshje, as Bazike, as marrëveshje bazike me Kosovën. Për Serbinë është një dokument pune, mbi të cilin do vazhduar negociatat.

Këtë asimetri me ushtrim jociësor letërsie në gjuhë burokratike J.Borell e shndërroi në Marrëveshje ligjërish të obligueshme. Teknikisht është diçka që futet në sirtarët burokratikë të Brukselit si një prej dokumenteve me të cilat matet integrimi i Serbisë në BE dhe ai i Stabilizim-Asociimit të Kosovës.

Është pak a shumë ajo që i konvenon presidentit Vuçiq për të treguar se nuk ka Marrëveshje dhe për BE-në për të treguar se ka Marrëveshje. Për ve-

turën e negociatave është një rrotë mangët.

Rrota e dytë mangët është Banjaska. Një grup paraushtarak i prirë nga M.Radoiçiq, bashkëpunëtor i afërt i presidentit Vuçiq, sulmoi Kosovën afër Manastirit të Banjaskës, në një operacion që mund të kishte qenë fillimi i një konfrontimi më të gjerë të armatosur, mes njëseve paraushtarake të stërvitura në Serbi dhe forcave të sigurisë në Kosovë, përfshirë edhe KFOR-in.

Ka kaluar një muaj nga ky sulm dhe ende nuk janë kryer tri gjëra thelbësore. Një, nuk është hartuar një raport përmbledhës (nga KFOR-i, EULEX-i, autoritete të Kosovës, autoritete të Serbisë) mbi atë që ndodhi, duke treguar nivelin e përfshirjes së strukturave shtetërore të Serbisë në të.

Dy, nuk ka ndodhur delegjitimimi i përdorimit të dhunës nga ana e autoriteteve të Serbisë, por përkundrazi u shpall ditë zie për tre pjesëtarët e vrarë të njësitit paraushtarak dhe u legjitimua veprimi i tyre në fjalorin e autoriteteve zyrtare dhe në ligjërimit publik.

Dhe tre, nuk ka ndodhur delegjitimimi

i këtij veprimi: M.Radoiçiq është ende në liri, ndonëse ka pranuar përgjegjësinë për organizimin dhe veprimin e formacionit paraushtarak.

Një muaj më pas, dhe kur njëra palë konsideron se mund të zhvillohen negociata e njëkohësisht të dërgohen formacione paraushtarake ndoshta për të ndërtuar pozicion më të favorshëm negociator (me “realitete të reja”), është vështirë të mos hetosh se vetura ka mbetur edhe pa një rrotë.

3. Problemi nuk qëndron te presidenti Vuçiq.

Ai ka transmetuar saktësisht se çka dëshiron dhe çka nuk dëshiron, çka do të bëjë dhe çka jo. Prej fillimit të vitit ka thënë shprehimisht, gojarisht dhe me shkrim se nuk e pranon Marrëveshjen bazike në tërësi, se ka gjëra që do të zbatohet dhe ka gjëra që nuk do të zbatohet. Gjatë tërë vitit ka thënë se nuk do të bëjë asnjë hap në negociata pa formimin e Bashkësisë së komunave serbe (ndërkohë është harruar shtesa “e komunave me shumicë serbe”). Prej nëntorit të vitit të kaluar, pas tërheqjes së policëve, gjyqtarëve e zyrtarëve të tjerë nga shërbimi në institucionet e Kosovës të katër komu-

nave të pjesës veriore të vendit, ka deklaruar se “veriu i Kosovës është i okupuar”; një deklaratë që mund të ketë qenë inspiruese për cilindo që të jetë ndier i ftuar të formojë apo të marrë pjesë në grup paraushtarak për çlirimin e kësaj pjese të “okupuar”. Problemi qëndron te ndërmjetësit që përpigjen të ndërtojnë një interpretim ndryshe të fjalëve të drejtpërdrejta të tij. Dhe, kur konfrontohen me kokëfortësinë e realitetit, si për shembull me Banjaskën si produkt i drejtpërdrejtë i një ndërmjetësimi të dështuar të BE-së, dalin me arsyetimin e fjalëve të tij: “Presidenti Vuçiq nuk mund ta nënshkruajë Marrëveshjen, sepse është i kufizuar nga Kushtetuta e tij”, por kjo nuk na pengon të vazhdojmë. Të vazhdojmë pa rrota. Kjo quhet “disonancë kognitive”, është mbajtja e dy pohimeve të kundërta dhe në shembullin që jepnin psikologët në vitet pesëdhjetë të shekullit të kaluar është sikur duhanxhiu që pohon se pirja e duhanit është e dëmshme për shëndetin, por ai pi sepse nuk e dëmton shëndetin e tij personalisht.

4.

Nuk besoj të ketë qenë ndjenjë e mirë që misioni Prishtinë-Beograd i pesëshes së të dërguarve perëndimorë

të mos ketë lexuar një kontekst tjetër. Po, ata fluturonin për në dy qytetet ndërsa po zhvillohen dy luftëra të tmerrshme, në Ukrainë dhe në Izrael, me një besim se duhej ta hiqnin prej rendit të ditës një problem që për krahësim është guralec në këpucë. Por konteksti tjetër është se misioni që një përpjekje për të nxjerrë diçka para se Serbia të arrijë në zgjedhjet e veta parlamentare dhe vendore më 17 dhjetor të këtij viti. Kushdo që nuk e ka lexuar këtë kontekst nuk do të kuptojë se është fare joproduktive të kërkosh diçka në negociata, posaçërisht diçka që perceptohet si koncesion nga ai që hyn në zgjedhje. (Apo ndoshta koncesioni është menduar t’i kërkohet palës që nuk hyn në zgjedhje?)

Leximi i thjeshtë, apo madje i thjeshtësuar, i kësaj vizite mund të ketë qenë i formuluar në konferencë shtypi, “po, ndodhi Banjaska, por ne duhet të vazhdojmë me zbatimin e Marrëveshjes bazike, madje kjo është arsyeja më e fortë për të vazhduar”. Që është, pak a shumë, “po, tash jemi pa dy rrota, por nëse hipni në këtë veturë do të arrijnë që të gjithë së bashku në cak”.marre nga koha

# ARRITJA NË ÇAK PA DY RROTA



# Dëshironi një **Banner** për biznesin tuaj?



- **Business Cards**
- **-Logos**
- **-Invoices**
- **-Posters**
- **-Banners**
- **-Video Marketing**
- **-Online Marketing**

 **Adresa e zyrave: 30 Avenons Road London E13 8HT**

 **Tel: 020 7018 7929 Mob: 073 4066 5946**  
**Mob: 078 5997 7545**

## DITMIR BUSHATI

Kur një grup i armatosur rëndë sulmoi policinë në veri të Kosovës më 24 shtator, duke vrarë një polic dhe duke plagosur dy të tjerë, për shumëkënd nuk duhet të ishte befasi. As shpallja e 27 shtatorit ditë zie nga ana e Serbisë në nderim të autorëve të sulmit, si legjitimim i politikës së agresionit ndaj fqinjëve. Veprimet e Serbisë janë shqetësuese, por jo për t'u habitur, duke pasur parasysh rolin e saj si prishëse e stabilitetit rajonal, glorifikimin e vazhdueshëm të kriminelëve të luftës dhe politikës së revizionimit të historisë të ndjekur vijimisht nga presidenti serb.

Sulmi i 24 shtatorit është më i sofistikuari i një serie aktesh të ngjashme të dhunshme nga bandat e armatosura kriminale serbe, të cilat gradualisht kanë ardhur në rritje. Pak muaj më parë, tre policë të Kosovës u rrëmbyen nga forcat serbe. Në të njëjtën kohë, trupat e KFOR-it, gazetarët dhe policia e Kosovës u sulmuan nga bandat kriminale serbe. Situata e tensionuar në veri të Kosovës e ka origjinën në vendimin dritëshkurtër të inspiruar nga Beogradi, për braktisjen e institucioneve të Kosovës nga ana e serbëve, përfshirë edhe forcat e sigurisë së Kosovës. Duhet thënë se Serbia ka nxitur vijimisht aktet e dhunës për të sfiduar funksionalitetin e shtetit të Kosovës, sidomos në veri, me qëllim imponimin e autonomisë së katër komunave, gjë që do t'i lejonte Serbisë të ndërhynte në punët e brendshme të Kosovës përmes përfaqësuesve të saj.

Reagimi i Perëndimit ka qenë më së shumti qortues ndaj veprimeve qeverisë dhe institucioneve të Kosovës, që në thelb synonin zbatimin e ligjit në të gjithë territorin e saj. Ndërkohë që Marrëveshja e Brukselit dhe Aneksi i Ohrit, të ndërmjetësuar nga BE-ja mes Kosovës dhe Serbisë, dokumente që nuk janë nënshkruar nga Serbia, duket se u reduktuan në themelimin dhe mënyrën e funksionimit të Bashkësisë së Komunave me shumicë serbe, duke eklipsuar çështje të tjera themelore për ndërtimin e raporteve të shëndetshme ndërmjet dy fqinjëve.

Prandaj Presidenti i Serbisë vijoi me të njëjtën alibi, duke e cilësuar sulmin e 24 shtatorit, si një akt legjitim të rezistencës nga serbët vendas, i cili nuk do të kishte ndodhur nëse Bashkësia e Komunave me shumicë serbe do të ishte krijuar. Por lloji dhe sasia e armëve të sekuestruara, sugjerojnë se ky ishte një operacion i madh dhe i bashkërenduar me synim destabilizimin e Kosovës dhe me implikime të pashmangshme për sigurinë e rajonit. Thënë ndryshe, ky operacion më shumë kishte të bënte me Beogradin dhe synimet e tij sesa, me serbët e Kosovës.

Në rrethanat e tanishme politike dhe të sigurisë në Europë episodi i fundit është një këmbanë e fortë alarmi. Në dallim nga dy konfliktet e tjera të mëdha në Europë, pushtimi rus ndaj

## RENDI I NGRIRË



Ukrainës, apo konfliktit në Nagorno-Karabakh, agresioni i Serbisë ndaj Kosovës mund të lexohet edhe si sulmi i një shteti kandidat për anëtarësim në BE, ndaj një shteti që ka aplikuar për anëtarësim në BE. Vështruar në këtë kontekst, përfundimi i konfliktit që po merr trajtat e një rendi të ngrirë nuk është më një çështje politike, por një çështje serioze e sigurisë për rajonin dhe të ardhmen e Europës. Për SHBA-në dhe BE-në, zgjedhja nuk është më vetëm mes dështimit dhe suksesit të dialogut, por ndërmjet stabilitetit dhe një përshkallëzimi të mëtejshëm të dhunës. Kjo e fundit ka shumë të ngjarë të ndodhë nëse tolerohet roli i Serbisë, si prishëse e stabilitetit rajonal.

Serbia, nxitëse e lufrave në ish Jugosllavi nuk pranon realitetin e pasluftës, duke kundërshtuar në çdo mënyrë shtetësinë e Kosovës, funksionalitetin e Bosnje-Hercegovinës dhe Malit të Zi. Megjithëse kanë kaluar më shumë se dy dekada nga përfundimi i lufrave në ish Jugosllavi, Serbia ende nuk ka nxjerrë mësim dhe përgjegjësi për krimet e kryera gjatë luftës. Serbia e sotme nuk ka asnjë lidhje me Gjermaninë e pas Luftës së Dytë Botërore, ku Kancelari Konrad Adenauer përqafoi të ashtuquajturën “strategji të përlulesisë”, e cila përbëhej nga katër elementë: pranimi i pasojave që vijnë për shkak të humbjes së luftës; rifitimi i besimit në raport me fitimtarët; ndërtimi i një shoqërie demokratike; dhe krijimi i një Federate Europiane që do të tejkalonte ndarjet historike të Europës.

Politikat e Presidentit të Serbisë për më shumë se një dekadë janë në kah të kundërt me të gjithë elementët përbërës të shembullit të mësipërm gjerman, si rruga e vetme drejt pajtimit rajonal, integritet euro-atlantik dhe pranimit të arkitekturës së sigurisë rajonale, që bazohet tek bashkëjetësa multi-etnike dhe mosndryshimi i kufijve.

Në rrafshin e brendshëm, Serbia është rasti tipik i një qeverisje joliberales e jodemokratike, i përqendrimin të të gjitha pushteteve në duart e një njeriu, çka nuk mundëson një debat të vërtetë e kritik për krimet e së shkuarës, kërkimndjesën ndaj fqinjëve dhe vullnetin për të ecur në rrugën europiane. Në rrafshin ndërkombëtar, Serbia ndjek rrugën oportuniste me të gjithë aktorët kryesorë ndërkombëtarë, duke shfrytëzuar të çarat e Perëndimit dhe nevojën këtij të fundit për qetësimin e Ballkanit Perëndimor, në kushtet kur i duhet të përballojë pasojat e agresionit rus në lindje të kontinentit. Objektivi strategjik i Perëndimit përmes ushtrimit të diplomacisë kreative me Serbinë me qëllim largimin e saj nga orbita ruse dhe përfshirjen në rrjedhat europiane qartazi nuk është përmëshur. Përkundrazi, megjithëse shtet kandidat për anëtarësim në BE dhe shteti më i ndërlidhur në rajon me ekonominë europiane, Serbia nuk i është bashkuar sanksioneve të BE-së ndaj Rusisë. Fjalimi i fundit i Presidentit serb në Asamblesë e Kombeve të Bashkuara ishte i mbushur me akuza ndaj Perëndimit.

Në rrafshin rajonal, Serbia përpigjet të mbajë vendet e rajonit nën kthetër e dominimit e presionit të vazhdueshëm, dhe ndërtimit të marrëdhënieve të përzemërta me Shqipërinë, duke synuar përçarjen e faktorit shqiptar në rajon. I vetëdijshëm se pavarësia e Kosovës, e vulosur edhe nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë pas një sërë procesesh të udhëhequra nga partnerët ndërkombëtarë, është një proces i pakthyeshëm, Presidenti i Serbisë synon për serbët në Kosovë një qeverisje autonome duke mos e njohur pavarësinë e Kosovës. Ndërkohë që çdo formë përfaqësimi dhe qeverisje e serbëve në Kosovë duhet të ketë si pikënisje njohjen e autoritetit të shtetit të Kosovës. Në këtë kontekst, BE-ja dhe SHBA-të duhet të mbështesin një zgjidhje institucionale ndërmjet Kosovës dhe serbëve të Kosovës, e cila nis me pranimin e autoritetit shtetëror dhe lejon vetë-ad-

ministrimin e tyre të mirëfilltë kulturor, arsimor dhe fetare, pa mundësuat ndërhyrjen e Beogradit në punët e brendshme të Kosovës.

Për SHBA-në dhe BE-në, zgjedhja nuk është më vetëm mes dështimit dhe suksesit të dialogut, por ndërmjet stabilitetit dhe një përshkallëzimi të mëtejshëm të dhunës. Kjo e fundit ka shumë të ngjarë të ndodhë nëse ata tolerojnë rolin e Beogradit në destabilizimin e Kosovës dhe nëse nuk përqafojnë një qasje të fuqishme për ta kundërshtuar atë.

Dërgimi i trupave ushtarake serbe në kufi me Kosovën është pjesë e një strategjie të përsëritur nga Presidenti i Serbisë që synon krijimin e një krize më të madhe për t'iu shmangur përgjegjësisë për atë të mëparshmen. Pra, mosdorëzimin e atyre që organizuan sulmet terroriste në Kosovë dhe mospranimin e një hetimi ndërkombëtar. Reagimi i shpejtë i aleatëve të NATO-s u pasua nga tërheqja taktike e forcave nga Presidenti i Serbisë, por jo nga tërheqja e qëllimeve të tij. Ato mbeten të pandryshuara: formimi i Bashkësisë së Komunave me shumicë serbe dhe zëvendësimi i forcës policore të Kosovës me KFOR-in, misioni dhe fusha e përgjegjësisë së të cilit është e ndryshme nga ajo e policisë së Kosovës.

Presidenti i Serbisë i druhet pasojave katastrofike të një konfrontimi të mundshëm të forcave serbe në kufi me Kosovë. Ai mund të kujtojë me nostalgji popullaritetin e Millosheviçit gjatë bombardimeve të NATO-s ndaj Serbisë, por kurrësesi fundin e regjimit të tij. Megjithatë, nuk duhet të nënvlerësohet kërcënimi i sigurisë që vjen si pasojë e përshkallëzimit të Serbisë. Në të njëjtën kohë, nuk duhet lejuar që taktikat përshkallëzuese të Serbisë të formësojnë kushtet e zgjidhjes politike. Pra, të legjitimojnë ndërhyrjen e përhershme politike të Serbisë në Kosovë përmes strukturave dhe mekanizmit institucional, e cila në një periudhë afatgjatë, nuk siguron paqen dhe stabilitetin, por destabiliz-

imin e përhershëm.

Para shpërthimit të luftës në Ukrainë, Rusia kishte interes të ruante tensionet në Kosovë, por jo të nxiste një luftë. Gjërat kanë ndryshuar që atëherë. Rusia ka një interes të qartë për të krijuar sa më shumë konflikte në botë, jo vetëm për të dobësuar Perëndimin, por për të ndërkombëtarizuar luftën e saj me Ukrainën, në mënyrë që një zgjidhje përfundimtare, kur të vijë, të kryhet përmes rinegociimit të rendit botëror ekzistues. Ndryshe nga Rusia, Perëndimit nuk i nevojitet një konflikt tjetër në Europë, ndërkohë që është përqendruar tërësisht në mbështetjen e Ukrainës për të përballuar agresionin rus. Uniteti, koherenca dhe vendosmëria e demonstruar nga BE-ja si përgjigje ndaj agresionit të Rusisë kundër Ukrainës, duhet të dëshmojë edhe për çështjet kyçe të sigurisë në Ballkanin Perëndimor, të cilat po marrin trajtën e një rendi të ngrirë. Perëndimi duhet të insistojë në hetimin e plotë të ngjarjeve të 24 shtatorit, dorëzimin nga ana e Serbisë të autorëve të sulmit terrorist në Kosovë dhe nxitjen e strukturave të Këshillit të Europës për të hedhur dritë mbi ngjarjen.

Edhe pse në kushte krejt të reja për sa i përket mjedisit të sigurisë në Europë, pesë shtete anëtare të BE-së, katër prej të cilave anëtare të NATO-s, ende nuk e njohin pavarësinë e Kosovës. Lëvizja e tyre drejt njohjes do të shtonte besueshmërinë e BE-së si ndërmjetësuese, por edhe shanset e zbatimit të planeve europiane për rajonin. Në të njëjtën kohë, do të rriste presionin ndaj Serbisë për të njohur realitetin e pasluftës në ish Jugosllavi dhe për të ecur në drejtim të rrugës europiane. Përfshirja e Kosovës në programet e Partneritetit për Paqe në NATO tanimë përbën domosdoshmëri.

Për shtetësinë e Malit të Zi, BE-ja ishte e bashkuar. Madje, ajo luajti një rol të rëndësishëm ndërmjetësues në përgatitjen e kushteve për referendumin e pavarësisë së vendit. Format i tanishëm i ndërmjetësimit të BE-së është ezauruar, në mungesë të një qasje të unifikuar dhe plani konkret anëtarësimi në BE për Kosovën dhe Serbinë. Përqafimi i një qasjeje aktive nga BE-ja në rajon do të çimentonte rolin e saj si një aktor efektiv në tejkalimin e mosmarrëveshjeve dhe adresimin e tyre në një plan më të gjerë europian. Njëkohësisht, do të garantonte një proces anëtarësimi të vendeve të rajonit në BE, të bazuar në merita dhe jo të eklipsuar nga mosmarrëveshjet e mësipërme.

NATO dhe BE duhet të projektojnë vizion, fuqi, dhe vullnet për ta materializuar shtetësinë e Kosovës dhe europianizimin e Serbisë, duke shmangur realizimin e interesave afatshkurtër transakcionale që nuk prodhojnë zgjidhje të qëndrueshme dhe stabilitet demokratik afatgjatë. Fokusi i ri gjeopolitik i Europës duhet të bëjë të mundur shkrirjen e këtij rendi të ngrirë në Ballkanin Perëndimor dhe njëkohësisht ankorimin e vendeve të rajonit në BE.

\*Analiza është botim i Fondacionit “Friedrich Ebert”

ARMAND SHKULLAKU

Prokuria Speciale kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit, SPAK, ka ngritur dyshime të forta mbi pavarësinë e saj, me mënyrën që ka zgjedhur për të vënë nën akuzë ish kryeministrin, Sali Berisha. Të paktën nga çka është bërë publike deri tani, Sali Berisha akuzohet se përpara 15 vitesh, në funksionin e kreut të qeverisë, ka kryer korrupsion pasiv duke favorizuar 5 familje ish pronarësh, mes tyre edhe dhëndri i tij, për të privatizuar terrenet e klubit Partizani, ku më pas janë dhënë leje ndërtimi nga bashkia për 17 godina banimi.

Ky veprim i SPAK, prek thelbin e dyshimit bazë mbi këtë institucion, se deri më sot ai nuk ka shkuar kurrë te procedurat që kanë prodhuar skandale të rënda në këto 10 vite, më eklatanti ai i inceneratorëve, por është kufizuar vetëm në hetimin e pasurisë së personave të dyshuar si të përfshirë në afëra korruptive.

Mosbesimi kryesor ndaj SPAK, lidhur me hetimin e dosjeve të ndjeshme të korrupsionit qeveritar, ka patur të bëjë pikërisht me kontrollin politik ndaj tij ose pamundësinë për të shkuar tek kokat që kanë projektuar dhe zbatuar skemat zvatëse të PPP dhe koncesioneve, të cilat rezultojnë totalisht korruptive. Në asnjë hetim deri më tani, organi special i akuzës, nuk ka depërtuar tek procedurat e vendimmarjes, por është mjaftuar me gjurmimin e pasurisë së disa zyrtarëve të lartë.

Akuza e ngritur mbi Sali Berishën, rrëzon pafhtësinë apo pamundësinë e

prokurorëve për të shkuar deri tek vendimmarja politike, duke përfunduar tezën se organi i ri i akuzës lëviz sipas konjunkturave të përcaktuara nga pushteti. Nëse për ish kryeministrin dhe kreun e opozitës, hetimi ka shqyrtuar aktet, emërimet, vendimet e qeverisë së atëhershme, çfarë e pengon SPAK të ndjekë të njëjtin parim edhe për skandalet e qeverisë së sotme, që kanë kërrusur ekonominë e vendit me pasojat e tyre katastrofike.

Çfarë parimi apo standarti e ndalon SPAK të shqyrtojë fjala vjen si u dha dhe kujt iu dha koncesioni i check-up qysh në fillim të qeverisë së parë Rama. Si u përzgjedh pa garë një kompani pa përvojë për të ngritur inceneratorin e Elbasanit dhe si u gënjy publikisht mbi pronësinë e së njëjtës kompani në të tre impiantet e djegësive. Pse kryeministri Rama dhe kabineti i tij miratuan në kohë rekord aktet dhe kontratën për koncesionin e Elbasanit dhe pse e mbrojtën hapur këtë projekt, që sipas Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe se fundmi të vetë SPAK, ishte fund e krye korruptiv. Për këtë e shumë skandale të tjera, organi i ri i akuzës, nuk guxoi të rrëmonte më shumë se shtëpitë e grave të Arben Ahmetajt, rrogës së babait të Alqi Bllakos apo faturimeve për punë të pakryera të djalit të Lefter Kokës.



Garancia se SPAK nuk kishte këllqe për të shkelur kufirin që kishte caktuar pushteti, shpjegon edhe sigurinë e Edi Ramës kur përsërit me zë të lartë se edhe 100 herë po t'i jepej rasti do t'i ribënte PPP dhe koncesionet që sot rezultojnë në afëra të pastra korruptive. Sepse kryeministri e ka përcaktuar vetë se deri ku duhet të shkojë hetimi i drejtësisë së re. Sipas tij, ky hetim nuk duhet të merret me procedurat, sepse ato janë të pafajshme dhe qenkëshin nxitur nga vullneti i mirë, por me ata që hanë dardha dhe mollë pas shpinës së tij. Dhe deri më sot SPAK e ka "respektuar" direktivën, duke luajtur vetëm në terrenin që i ka caktuar shefi i qeverisë dhe duke "ngrënë" ata që lëshon ai.

Në rastin e Sali Berishës, prokurorët

dëshmuar se dinë të luajnë edhe në një terren tjetër, por vetëm kur kanë leje për ta bërë këtë. SPAK, që ende nuk ka një akuzë përfundimtare për tjetërsimin e pronave të ushtrisë në vitet e fundit, me një vullnet të admirueshëm ka shqyrtuar çdo shkresë të 15 viteve më parë, për një terren sportiv që vetëm në letra figuronte si aset i ministrisë së Mbrojtjes. Të njëjtët prokurorë që nuk e kanë parë të udhës të hetojnë mbledhjet e qeverisë që i hapën rrugë ngritjes së inceneratorëve, që edhe sot janë kosto për qytetarët, ishin marrë me procesverbalet e një dekade e ca më parë të kabinetit Berisha dhe plot detaje të tjera. Për të kulmuar me kontrastin ulëritës, që për çështjet e nxehta të korrupsionit të hetuara apo në hetim, Edi Rama nuk u mor asnjëherë në pyetje,

ndërsa ndaj ish kryeministrit u vendos masë detyruese dhe dhëndri i tij u arrestua me pompë në aeroport a thua se bëhej fjalë për bosin e ndonjë narkotrafiku.

Ja pra, që vullnet paska, por mungon liria për të vepruar. Për njërën palë aplikohet standarti i procedurave të pafajshme dhe i qafirëve që përfitojnë prej tyre, ndërsa për palën tjetër zhburohet çdo procedurë si e fajshme që në zanafillë. SPAK është në të drejtën e tij të hetojë Sali Berishën në çdo aspekt të veprimtarisë së tij, për të cilën dyshon se mund t'i ketë hapur rrugë një afere korruptive, por është i detyruar që të njëjtin standart ta zbatojë dhe për ata që korrupsionin e kanë bërë autostradë në këto 10 vite. Nuk mundet që dikush t'i hedhi firmat fap-fap dhe të prezumohet i kulluar në qëllimet e tij vetëm se është në pushtet dhe dikush tjetër t'i ketë hedhur si mëkatar vetëm se është në opozitë.

Pas vënies nën akuzë të Sali Berishës, SPAK më së pakti do duhet të ndjekë të njëjtin parim edhe për dosjet e nxehta të qeveritarëve të sotëm. Të shkojë tek procedura. Përndryshe nga një instrument i ri i drejtësisë, do të shndërrohet në vegël të vjetër të qeverisë. ©lapsi.al

ANDI BUSHATI

Arrestimi i dhëndrit të Berishës, Jamarbër Malltezi, dhe kufizimi i lirisë për ish kryeministrin, ka nxjerrë edhe njëherë në sipërfaqe papagallët e sponsorizuar të reformës në drejtësi, të cilët kanë shpallur me të madhe mbylljen e epokës së pandëshkueshmërisë. Në fakt, pyetja që shtrohet është tjetër: a ka marrë fund pandëshkueshmëria, apo vetë drejtësia, që duhet ti trajtonte të gjithë, si të barabartë para ligjit? Natyrisht, çështja e privatizimit të klubit Partizani, për të cilën u prangos dhëndri dhe pothuajse u arrestua Berisha (vetëm moshë mbi 75 vjeç e favorizoi për masa më të buta) është një histori të cilës i duhet shkuar deri në fund. Unë personalisht e kam denoncuar tjetërsimin e një objekti sportiv dhe kthimin e tij në shesh ndërtimi, që gjatë kohës kur Berisha ishte në pushtet dhe vazhdoj të mendoj se bashkë me ngjarje si Gërdec, apo 21 janari, ajo është një nga historitë që e ka njollësuar qeverisjen tetë vjeçare të demokratëve. Por, thënë këtë, duket se SPAK dhe Gjykata e posaçme kanë pasur më së paku standarte të dyfishta dhe me e shumta,

motivim politik, në qëndrimin ndaj Sali Berishës.

Le ta shpjegojmë shkurtimisht. Mes viteve 2008-2012, një bashkim familjesh pronarësh të vjetër, privatizojnë klubin sportiv Partizani, që deri më atëherë i përkiste ministrisë së Mbrojtjes. Në krye të përfaqësimit të tyre ligjor vihet Jamarbër Malltezi. Procesi kryehet nga një sërë institucionesh me shpejtësi të madhe dhe pretendohet se punonjësve që nuk donin të nënshkruanin u ushtrohet presion. Si përfundim, në këtë truall, ngrihen 17 kulla, ku dyshohet se Malltezi ka marrë më shumë pjesë sesa i takon si pronar, pasi ai është shpërblyer për ndikimin që ka pasur si dhëndër i shefit të qeverisë.

Çdo shqiptar që i lexon këto rradhë e pranon me gojën plot: Epo natyrisht që ka ndodhur kështu, pasi ai kishte në favor vjehërin kryeministër. Duket sikur edhe SPAK ka ndjekur të njëjtin logjikë, duke nxituar të akuzojë Berishën për korrupsion pasiv dhe duke kërkuar nga ai detyrim paraqitje dhe pengesën për të udhë-

tuar jashtë shtetit.

Nëse Berisha dyshohet se për këtë dosje e gjithë administrata dhe pjesa politike e ministrive ka vepruar nën presionin e tij, a nuk është pikërisht kjo fabula për të cilën Edi Rama akuzohet tek inceneratorët, koncesionet në shëndetësi, apo gjete?

Këtu qëndron, në fakt, kërcitja e madhe. Në rastin e kryeministrit që është në pushtet, SPAK ka adoptuar alibinë e këtij të fundit, se keqbërësit kanë ngrënë kumblla dhe dardha pas shpinës së tij. Pra, se Edi Rama, është i pastër, por e kanë tradhëtuar bashkëpunorët rrugës.

Ndërsa, për kryeministrin që ka rënë nga pushteti, që për më tepër është edhe lideri i opozitës, kuti është i ndryshëm: Nuk mund të ndodhë gjë poshtë, pa urdhëruar ai që ka në dorë dhe gurin dhe arrën. Pra e njëjta njësi matëse që të parin e pastron, shërben që të dytin ta penalizojë. Askujt nga drejtësia nuk i ka shkuar në mend alibia qesharake e përdorur për Ramën, se dhëndri mund të ketë komplotuar pas shpinës së vjehërit.

Dhe nuk mbaron këtu. Në çështje si ajo e inceneratorëve, për shembull, vjedhja tashmë është e verifikuar, paratë janë gjetur se ku kanë shkuar dhe sërish kryeministri nuk preket. Në rastin e dosjes "Partizani", abuzimi është ende një proces në hetim, por kaq majafton që të shkohet drejt e tek ish kreu i qeverisë.

Privatizimi i kompleksit/ Berisha: 'Partizanin' e nisi Nano, e firmosi Rama, jo unë

Në çështjen e parë, protagonistët kryesorë lihen të shpëtojnë burgut, ndërsa Malltezi prangoset në një nga mjediset më publike të vendit, në aeroportin e Rinasit dhe filmohet për tu bërë shembull.

Në raste të tjera, si Tahiri apo Ahmetaj, procedurat parlamentare për ti hapur rrugë prokurorëve zgjasin e zgjasin, kurse për Berishën shkelet kushtetuta, duke marrë vendimin e kufizimit të lirisë, pa miratimin e kuvendit.

Nëse Rama nuk është guxuar as të merret njëherë në pyetje, Berisha akuzohet dhe duhet të dorëzohet pasha-

portën, a thua se ndokush ka frikë se ai mund të bëjë atë që në fakt do të uronin të gjithë armiqtë e tij, të arratiset.

Po të shtosh këtu, emrat e spakistëve që e kanë marrë vendimin, koordinimin mes pjesës politike dhe asaj të prokurorisë për të kryer aksionin, mënyrën se si u furnizuan mediat, duket qartë se peshorja e drejtësisë është zbalancuar frikshëm.

Prandaj, duhet të jesh i shitur kokë e këmbë, që për këtë drejtësi me dy standarte, të shpallësh hapjen e një faqeje të re në histori. Dosja "Partizani", domosdoshmëria e zbardhjes reale të së cilës, as që vihet në diskutim, nuk mund të shërbejë si ilustrim për këtë fabul të shëmtuar. Përpara se të shënojë fundin e pandëshkueshmërisë, ajo po përforcon një dielmë tjetër: a kemi të bëjmë një drejtësi vulnerabel ndaj më të fuqishmëve, apo në të kundërt, kemi mbërritur në një fazë të re, në atë kur këta të fundit po e përdorin si mjet për të goditur rivalët.

## PO SIKUR JAMARBRI TË KETË NGRËNË KUMBULLA PAS SHPINËS SË SALIUT?



AUGUSTIN PLOKAJ

Javën e shkuar vdiq Marrti Ahtisaari, ish-Presidenti i Finlandës, i njohur si njëri prej ndërmjetësuesve më të mirë që ka njohur bota për zgjidhjen e konflikteve të ndryshme. Për punën e tij, përfshirë edhe në zgjidhjen e statusit të Kosovës, ai kishte fituar edhe çmimin Nobel për paqe. “Nëse nuk mundet Ahtisaari, nuk mundet askush”, thoshte një zyrtar i lartë i BE-së, kur Ahtisaari ishte emëruar si i dërguar i posaçëm i sekretarit të përgjithshëm të OKB-së për të udhëhequr procesin e zgjidhjes së statusit të Kosovës. Vetë Ahtisaari më vonë në disa raste tha se ai ka pasur gjithmonë disa kushte për të marrë ndonjë përgjegjësi si ndërmjetësues. Së pari, ai insistonte që të dihej se cili është synimi.

Çfarë zgjidhje kërkohej. Ai nuk donte të ndërmjetësonte procese të pafundme në të cilat palët do të shprehinin në pakufi qëndrimet e tyre dhe asnjëherë nuk do të gjendej një zgjidhje. Në rastin e Kosovës, atij iu dhanë udhëzime, edhe me shkrime dhe me gojë. U tha se statusi i Kosovës, në një mënyrë apo tjetrën, duhet të jetë një lloj pavarësie nën mbikëqyrjen ndërkombëtare, në udhëtimet e Grupit të Kontaktit u tha se “nuk ka kthim në situatën e para vitit 1999”, që ishte qartë se Kosova nuk mund të jetë pjesë e Serbisë. Po ashtu, u tha se “statusi i Kosovës duhet të jetë i pranueshëm për popullin e Kosovës”, që ishte indikacion se bëhej fjalë për pavarësinë, pasi askush nuk kishte dilemë se këtë e do populli i Kosovës. Dhe, që ishte po aq e rëndësishme, u tha se kur të nisë procesi, ndonjë synohet një marrëveshje e pranueshme për të dyja palët, asnjëra palë nuk mund ta blloktojë procesin dhe ai duhet të përmbillet. Kështu ndërmjetësoi edhe në emër të OKB-së, edhe të BE-së, edhe të NATO-s, edhe të OSBE-së. Kishte në punën e tij elemente për rolin e të gjitha këtyre organizatave edhe në procesin e zgjidhjes së statusit të Kosovës, edhe pasi ai të zgjidhej. Por interes të veçantë kishte Bashkimi Evropian dhe shumica e madhe e ekipit të Ahtisaarit ishin nga BE-ja.

Me këtë pajtoheshin edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, sepse besonin në atë kohë, nëse diçka kanë të përbashkët Kosova dhe Serbia, atëherë kjo është e ardhmja e tyre brenda Bashkimit Evropian. Ahtisaari kur mori përsipër ndërmjetësimin e procesit për zgjidhjen e statusit të Kosovës dinte të thoshte se nga BE ka vetëm dy prirje. E para ishte që kur të dalë me propozim, BE-ja ta mbështesë propozimin e tij. Dhe e dyta, që BE-ja të

mbajë premtimin për perspektivën e integritimit në BE për vendet e Ballkanit Perëndimor. Në të dyja këto, BE-ja e tradhtoi Ahtisaarin. Kur ai doli me propozimin e tij, që shërbeu si bazë për shpalljen e pavarësisë së Kosovës, pesë vende të BE-së u rreshtuan krahas Ruisë dhe BE-ja nuk mbështeti asnjëherë propozimin e tij.

Si pasojë, BE-ja as sot nuk ka qëndrim unik rreth statusit të Kosovës. Dhe ndasitë rreth statusit kanë mbetur edhe 16 vite prej kur i ndjeri Ahtisaari kishte bërë propozimin e tij. As mendimi i GJND-së, që konfirmoi se shpallja e pavarësisë së Kosovës nuk e ka shkelur të drejtën ndërkombëtare, as nuk e ka shkelur Rezolutën 1244, nuk kanë mjaftuar që BE të ndërrojë qëndrimin. Ishte pranvera e vitit 2007, vetëm disa ditë pasi ishte bërë publike e ashtuquajtura “Pakoja e Ahtisaarit”, që më saktësisht ishte propozimi gjithëpërfshirës për statusin e Kosovës. Në qytetin e bukur gjerman Bremen ishin mbledhur në një takim joformal ministrit e Jashtëm të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian, i cili në atë kohë kishte 27 anëtarë.

Pritej që me kryesimin e ministrit të atëhershëm gjerman, Frank Walter Steinmayer, sot president i Gjermanisë, me rolin aktiv të përfaqësuesit të lartë Javier Solana, këto shtete të dëshmojnë unitet lidhur me problemin, i cili e mundonte aq shumë Evropën dhe zgjidhja e të cilit, do ta përmbyllte fazën e shpërbërjes së ish-Jugosllavisë. Në Bremen të Gjermanisë më 30 mars 2007 pritej që BE-ja qoftë edhe nga një takim joformal i njohur me emërtimin “Gymnich” të shprehë unitet lidhur me Kosovën. Një gjë e tillë pritej edhe duke u bazuar në fuqinë që ka Gjermania. Por kjo nuk ndodhi. BE-ja edhe atëherë, sikur që mundohet edhe sot, luante me fjalë për të manipuluar opinionin. Dolën në konferencë për shtyp Presidenti i sotëm i Gjermanisë Steinmayer, krahas Javier Solanës, dhe u thanë gazetarëve se kanë pasur një diskutim të hapur, konstruktiv dhe të frytshëm. Dhe, si konkluzion i tyre ishte se “të gjitha vendet e BE-së janë unike në mbështetje të përpjekjeve të Marti Ahtisaarit”.

Ku ishte manipulimi? Ishte te fjala “përpjekje”, sepse Ahtisaari nuk bënte më përpjekje. Ai i kishte kryer ato. Procesi i ndërmjetësuar nga ai kishte përfunduar dhe ai kishte bërë publike pakon e tij me propozimin për pavarësinë e Kosovës nën mbikëqyrje ndërkombëtare. Pra, BE-ja pritej të deklarohet se është unike në mbështetje të propozimit të Ahtisaarit, e jo të shpëtojnë fytyrën, duke mbështetur “përpjekjet e tij”. Të vërtetën që kishte ndodhur në takim gazetarëve ua kishte zbuluar një ministër i Jashtëm i një vendi të vogël, i cili kishte dalë nga takimi para se ai të përfundonte për të folur për media. Dhe ai ministër u kishte thënë gaze-

tarëve se në takim nuk ka pasur unitet, se shumica e shteteve mbështesin propozimin e Ahtisaarit për pavarësinë e Kosovës, të mbikëqyrur në fazën fillestare nga bashkësia ndërkombëtare, por se ka shtete si Spanja, Sllovakia, Greqia, Qipro dhe Rumania që mbështesin qëndrimin e Ruisë në interpretimet e tyre. Kur mediat gjermane shkruan për dështim të takimit Steinmayer i zemëruar në konferencë për gazetarë një ditë më vonë, tha se kanë porositur disa kolegë “që të kenë kujdes kur flasin për gazetarë”.

Në fakt, pas shumë vjetësh, nga diplomatët dëgjua se ministrit në fund të takimit ishin marrë vesh që para medive të aktojnë unitetin e BE-së, edhe pse e dinin se ai nuk ekziston në mbështetje të propozimit të Ahtisaarit. Pra, nuk kishte më nevojë për “mbështetje të përpjekjeve”, por kërkohej përgjigjja se a e mbështet BE-ja propozimin e tij. Që atëherë, gjithçka ka shkuar keq në sjelljen e BE-së ndaj statusit të Kosovës. Ndasi të kishin dalë në shesh edhe më qartë një ditë pasi Kosova shpalli pavarësinë. Ministri i Jashtëm i atëhershëm i Spanjës, Miguel Moratinos, duke shkelur një marrëveshje mes shteteve që askush të mos dalë me deklarata publike pa u miratuar “deklarata e përbashkët e Këshillit të BE-së” erdhi më herët në ndërtesën e Këshillit në Bruksel dhe gazetarëve u tha se, “shpallja e pavarësisë së Kosovës është shkelje drastike e së drejtës ndërkombëtare” dhe pastaj, vazhdoi ta krahasojë atë me ndërhyrjen amerikane në Irak dhe kështu, prishi tërë atmosferën edhe para se të niste takimi.

Deklarata e përbashkët doli si diçka krejt e paqartë, siç janë të paqarta edhe komunikatat e BE-së edhe sot kur bëhet fjalë për Kosovën. BE-ja nuk pati qëndrim të përbashkët fare për statusin e Kosovës. Madje, edhe në pjesën e deklaratës ku i referohet faktit se Kuvendi i Kosovës ka shpallur pavarësinë, nuk “merr në dijeni” shpalljen e pavarësisë, por “merr në dijeni” obligimet që ka marrë Kosova për t’i mbrojtur pakicat dhe për prani ndërkombëtare. Për dallim nga deklaratat në rastet e tjera kur ndonjë shtet ka shpallur pavarësi, si në rastin e Malit të Zi, ku u bëhet ftesë vendeve anëtare që me shtetin e ri të “vendosin raporte si me shtetet sovraane sipas ligjeve nacionale dhe ndërkombëtare” një thirrje e tillë për Kosovën mungoi. Deklaratat e pavarësisë për nga natyra e tyre janë unilaterale: Një entitet shpall pavarësinë e vet.

Shpallja e pavarësisë së Kosovës është më së paku unilaterale, sepse u bë krejtësisht në koordinim me bashkësinë ndërkombëtare, pas një procesi ndërkombëtar ku ishin përfshirë tri organizatat kryesore ndërkombëtare (OKB, BE dhe NATO) me pjesëmarrje aktive edhe të fuqive të mëdha si Rusia dhe SHBA. Prej negociatave e deri te shpallja e pavarësisë, gjithçka iu për-

shtat nevojave të BE-së dhe roleve që planifikoheshin për të. Por në fund BE-ja tradhtoi Ahtisaarin, duke mos pasur unitet për të mbështetur propozimin e tij dhe tradhtoi edhe Kosovën duke mbetur neutrale ndaj statusit. Kosova deri me sot i ka përmbushur obligimet nga Pakoja e Ahtisaarit ndërsa BE-ja, pos që ka bërë eksperimente me praninë e saj në Kosovë, jo edhe aq të suksesshme, nuk ka lëvizur nga vendi sa u përket obligimeve politike. Edhe BE-ja edhe shtetet që kanë mbështetur Kosovën kanë pasur mundësi që në këta 15 vjet të zgjidhin çështjen e subjektivitetit ndërkombëtar të Kosovës, por kanë dështuar.

Rasti më i mirë ka qenë pas shpalljes së mendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë. Në verën e vitit 2010 u paraqit ky mendim si një rast i jashtëzakonshëm për të siguruar njohje nga shtetet kyçe, sidomos nga ato shtete të BE-së, të cilat kundërshtonin pavarësinë e Kosovës, duke u thirrur në argumente të së drejtës ndërkombëtare. Më 22 korrik të atij viti, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, pikërisht duke u përgjigjur në pyetjen e Serbisë dha mendimin se shpallja e pavarësisë së Kosovës nuk shkel të drejtën ndërkombëtare e as nuk është në kundërshtim me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së.

U prit që BE-ja dhe NATO-ja do t’u thonë vendeve të tyre anëtare që nuk e kanë njohur Kosovën që tash ta bëjnë këtë, sepse nuk vlen më argumenti i tyre, pasi organi më i thirrur në botë për ta interpretuar të drejtën ndërkombëtare u shpreh se shpallja e pavarësisë nuk është në kundërshtim me normat e kësaj të drejte. Por me përjashtim të Parlamentit Evropian, asnjë organizëm tjetër i BE-së apo i NATO-s nuk bën mundim që të rrisin presionin për njohje. Në vend të kësaj, i tërë debati dhe fokusi nga ky mendim pozitiv që dha rast për njohje u bart në organizimin e dialogut mes Kosovës dhe Serbisë. Jo vetëm se u harrua njohja nga ana e 5 shteteve të BE-së, por BE-ja filloi ta konsideronte këtë mosnjohje nga 5 shtete të saj anëtare si një rrethanë të mirë.

Kur liderët e Serbisë nëpër takime në Bruksel ankohen se, “BE-ja po i mbështet shqiptarët e Kosovës dhe pavarësinë” si argument se nuk është e vërtetë një gjë e tillë, nga zyrtarët e BE-së dëgjojnë se, “BE-ja është neutrale ndaj statusit dhe nuk e konsideron Kosovën si shtet”. Nga zyrtarët e angazhuar në dialog diplomatëve u thuhet se “fakti se BE-ja është e ndarë në qëndrim rreth statusit është përparësi e jo dobësi e BE-së, sepse kështu ajo është në pozitë të jetë lehtësuesi më i mirë në dialog”. Rreth kësaj çështjeje shpesh në BE arsyetohen duke thënë se, “BE-ja nuk njih shtete, por kjo është kompetencë e vendeve anëtare”. Por pse atëherë liderët politikë të BE-së së paku nuk japin deklarata politike se do të ishte mirë që

të gjitha shtetet ta njohin Kosovën.

Ata deklarohen shpesh për çështje të tjera, për të cilat nuk ka konsensus në BE dhe pse atëherë hezitojnë që të deklarohen se a do të ishte mirë apo jo të njihet Kosova. Mosnjohja nga 5 shtetet e BE-së ia ka vështirësuar Kosovës jetën, ia ka vështirësuar edhe BE-së realizimin e politikës së zgjerimit në rajonin e Ballkanit, e ka bërë BE-në të duket qesharake në skenën ndërkombëtare ku dëshiron të “flasë me një zë” e nuk mund të ketë unitet as rreth një çështje kaq të rëndësishme në vet oborrin e BE-së, në Ballkan. Mosnjohja ia ka vështirësuar edhe Serbisë përballjen me realitetin e ri se Kosova është shtet. Këtë privatisht e kanë thënë edhe vetë disa politikanë serbë të cilët, qysh para se të shpallej pavarësia kishin tërhequr vërejtjen se nëse do të ketë shtete që nuk do ta njohin Kosovën, atëherë Serbia kursesi nuk mund ta bëjë këtë. Në këtë pikë jemi edhe sot, 15 vjet pas shpalljes së pavarësisë. Ndërsa me kalimin e kohës, Serbia po inkurajohet duke shpresuar se një ditë do të ndryshojnë rrethanat ndërkombëtare dhe mund të kthejë situatën në Kosovë në favor të saj.

Kjo ndasi në BE dhe NATO rreth statusit e Kosovës është bërë edhe rrezik potencial për sigurinë dhe stabilitetin në rajonin, sepse kuptohet si sinjal se nuk ka përfunduar ende vizatimi i kufijve të shteteve në Ballkan. Shembull i mirë është edhe aplikimi i Kosovës për anëtarësim në BE, i dorëzuar para më shumë se 10 muajsh, por që nuk është shqyrtuar fare nga Këshilli i Bashkimit Evropian. Ndërkohë, aplikime për anëtarësim në BE kanë bërë Ukraina dhe Moldavia që kanë marrë edhe statusin e kandidatit. Shpejt këtë status do ta marrë edhe Gjeorgjia. Dhe Kosova do të mbetet i vetmi vend në Evropë që ka aplikuar për status kandidatit, por nuk e ka marrë këtë status. Për të ndryshuar një qasje të tillë të paqartë të BE-së dhe NATO-s (në të dyja organizatat janë shtetet e njëjta që kundërshtojnë pavarësinë, me përjashtim të Qipros, e cila nuk është anëtare e NATO-s, por vetëm e BE-së) duhet një vullnet i madh politik nga niveli më i lartë i shteteve anëtare. BE-ja duhet ta kuptojë se mosanëtarësimi i Kosovës në OKB dhe mospranimi i propozimit të Ahtisaarit nga Këshilli i Sigurimit nuk është për shkak se po mbrohet e drejta ndërkombëtare siç dëshiron ta paraqesë Serbia. Por është keqpërdorimi politik i së drejtës së vetos nga Rusia që e ka penguar këtë. Nuk është bërë Kosova shtet “me vendime politike në kundërshtim të së drejtës ndërkombëtare”, siç thotë përditë Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, por me vendime politike po pengohet kompletimi i subjektivitetit ndërkombëtar të Kosovës si shtet. Dhe në këtë, kontribut të madh, ndoshta më të madhin e ka Bashkimi Evropian.

# EDI RAMA ËSHTË EKSPERT I PALLAVRAVE

ENVER ROBELLI

I pajisur me pushtet gati të paku-fishëm politik, por pa autoritet moral, Edi Rama ka kohë që ka hyrë në ujëra të zeza të debateve shterpe. Për të goditur Kosovën, së fundi ai po përpiqet të shpjegojë konfliktin e Palestinës duke e krahasuar me atë të Kosovës. Sa larg të vërtetës qëndron kryeministri i Shqipërisë, këtë e tregojnë faktet e lëvuara, për shembull, nga shkencëtarë gjermanë të Lindjes së Afërt. Por ky nuk është shembulli i vetëm. Një portret pa kornizë i Edi Ramës.

1.

Ka muaj që shumë kolegë nga mediat gjermane e zvicerane më pyesin: “A mund të na tregosh çka ka ky njeri me këto deklarata qesharake?” Ky njeri është Edi Rama. Pyetjen e kolegëve gjermanë e zviceranë ia bëra para disa ditësh edhe një miku në Tiranë. Përgjigja e tij ishte e shkurtër: “S’ka agjendë, ka veç protagonizëm amatoresk”. Zëra të tjerë në Tiranë thonë se Edi Rama ka agjendë, se ende është në sirtar plani i pluhrosur për “korigjimin e kufijve”, sipas të cilit një Kosovë me rreth 30 për qind territor më pak nuk do t’i mbetej gjë tjetër veçse t’i bashkohej Shqipërisë.

Edi Rama e ka krehur tashmë mjekrën për t’u dukur si Ismail Qemali dhe ndoshta ndonjë zdruckthar politik në Prishtinë është duke ia përgatitur shkallët për t’u ngjitur në një ballkon të improvizuar të ish-hotel Unionit në Prishtinë për ta shpallur “bashkimin e tokave tona”. Gjasat që kjo të bëhet realitet duken të vogla tani për tani, e me Edi Ramën madje nën zero. Vrojtues të tjerë në Tiranë serinë e deklaratave herë të çuditshme, herë absurde, herë qesharake, herë të rrezikshme të Edi Ramës sa i përket Kosovës e ndërldhin me rivalitetin e tij me kryeministrin e Kosovës Albin Kurti. Shkas për këtë i ka ofruar edhe Kurti me ndërhyrjen e tij në zgjedhjet parlamentare në Shqipëri, me parada patriotike nëpër Lezhë, me intervista në televizionet e Tiranës ku gazetarët kritikë ndaj Ramës e parashikonin Albin Kurtin si profetin kosovar që do ta çlirojë Shqipërinë nga korrupsioni e krimi dhe do të sjellë parajsën e mirëqeverisjes - diçka që Kurti, për fat të keq, nuk e ka arritur as në Kosovë gati tri vjet nga ardhja në pushtet.

Duhet kujtuar me këtë rast edhe diçka: dashuria e vëvëistëve të Albin Kurtit për Edi Ramën ka qenë aq e madhe dikur, sa që ata, pra deputetët e VV-së, nuk hynë në fillim të mbledhjes solemne të Kuvendit të Kosovës me rastin e 10-vjetorit të pavarësisë, sepse - dëgjoni, lexoni - deputetët e VV-së nuk dëshironin ta dëgjonin himnin e Kosovës, as nuk dëshironin të çoheshin në këmbë në nderim të simboleve kombëtare e shtetërore të Kosovës. Ama, deputetët e VV-së



hynë në sallën e Kuvendit të Kosovës kur Edi Rama nisi fjalimin e tij të qullët patriotik dhe propozoi që Kosova e Shqipëria të kenë një president të përbashkët. Këtë ai e thoshte për ndezje të ndjenjave patriotike të shtresave naive e folklorike në krye të së cilave ishte vënë edhe VV. (Për hir të së vërtetës duhet përkujtuar se edhe LDK para një fushate jo të largët elektorale i pati premtuar popullit se do ta bëjë flamur të shtetit të Kosovës flamurin e Ibrahim Rugovës).

Pa marrë parasysh motivet që e shtynjë Edi Ramën të merret me Kosovën ashtu siç po merret ai, e padiskutueshme është se Rama tashmë ka shkaktuar një dëm të madh politik dhe ka neveritur shumë njerëz në Kosovë. Sepse Edi Rama nuk ka ndjenjë mosdurimi vetëm ndaj Kurtit. E ka demonstruar këtë edhe ndaj Isa Mustafës dhe Ramush Haradinajt, të dy kanë qenë kryeministra të Kosovës. Vërtet, çka ka ky njeri? Që vjen në Kosovë dhe tallet me shqiptarët e Kosovës që s’po ditkan të dallojnë shqiptimin e shkronjave “ç” dhe “q”. Që vjen në Kosovë, futet në parlament, mban leksione të deformuara

të historisë dhe deputetët e LDK-së në shenjë proteste dalin nga salla e parlamentit. Që vjen në Kosovë dhe thotë se Vetëvendosje është pasuri kombëtare, atëherë kur VV hidhte gaz lot-sjellës në parlament - një veprim që e kam kritikuar atëherë dhe e kritikoj edhe sot. Sot Edi Rama mes rreshtave Vetëvendosjen e krahason me Hamasin, kur thotë se Palestinës ia mohuan lirinë pengmarrësit. Në këtë përshkrim si pengmarrës skicohen edhe pushtetarët e tanishëm në Kosovë, ndonëse legjitimitetin e tyre të fituar me vota nuk e kontestojnë as partitë opozitare, as mediat më kritike ndaj Kurtit, as shtetet perëndimore.

2.

Ka disa shqiptarë mendjeshkurtër që Edi Ramën e quajnë tradhtar. Nuk ka akuzë që ai e mirëpret më shumë. Në këto raste ai fërkon duart dhe shkruan gjerë e gjatë nëpër forume digjitale se si, sipas trutharëve shqiptarë, qenka “tradhtar”, “vëlla i Vuçiçit” etj., në të vërtetë, sipas autoportretit, Rama e sheh veten si vizionar. Përtej etiketimeve “tradhtar” apo “patriot” ia vlen, gjithsesi, të shihet se çfarë ka

dalë nga goja e Edi Ramës muajve e viteve të fundit. Para gati 10 vitesh mori guximin dhe tha në Beograd se Serbia duhet të pranojë Kosovën. Aleksandar Vuçiçi bëri atë që di më së miri: aktroi të hidhëruarin. Që nga atëherë Edi Rama duke u kyçur në valle politike të komponuara në Beograd (si projekti “Ballkani i Hapur”) dhe duke dhënë deklarata të pamatura lidhur me Kosovën e ka shndërruar veten në politikan vetëm dëmshkaktues. Jo vetëm ndaj Kosovës. Edhe ndaj Shqipërisë.

Një intermexo: ta lëmë për pak anash Albin Kurtin, të cilin Rama duket se nuk e duron më, e me gjasë antipatia tashmë është e dyanshme, por Rama dikur ka qenë i mllëfosur edhe me presidentin Hashim Thaçi, për shkak se ky ia bojkotoi një takim të “Ballkanit të Hapur” në Ohër.

Po ta merrte dikush seriozisht Edi Ramën në Perëndim, do të merrej seriozisht edhe plani që ai shkroi “me ekspertë eminentë” për bashkësinë e komunave serbe në Kosovë. Pa u konsultuar me qeverinë legjitime të Kosovës.

Ndërsa bota demokratike perëndimore i kërkonte Serbisë t’i vërë sanksione Ruisë pas agresionit kundër Ukrainës, Edi Rama dilte e bërtiste sokakëve politikë të Europës dhe Tiranës që Vuçiçi të lihej i qetë, të mos ngacmohej, sepse, sipas Edi Ramës, “pa Rusinë Serbia nuk mund të mbijetojë”. Kur politikanë në Kosovë (edhe të opozitës) paralajmëronin mbi rreziqet që Kosovës i kanosen nga Serbia, Edi Rama thoshte: “Ushtria serbe hyn në Kosovë vetëm si turistë”. Ose: “Nuk jam i shqetësuar për armatosjen e Serbisë. Nuk shoh arsye për t’u shqetësuar...”.

Futja e arsenalëve të armatimit nga Serbia në zonat e banuara me serbë në Kosovë, futja e bandave paramilitare, e njëjve terroriste dhe kontrabandistëve në shërbim të shtetit dhe sulmi i 24 shtatorit ku u vra një polic i Kosovës dhe disa u plagosën, qenë dëshmia më e parrëzueshme mbi rolin destruktiv të Serbisë në Kosovë - rol që Edi Rama bëhet sikur nuk e sheh. “Ushtria serbe”, thoshte Rama në maj 2023, “në kufi të Kosovës ka një fuqi të barabartë me zero.” Në atë kohë me gjasë banda e Milan Radoiçit po bënte përgatitjet finale në poligone të ushtrisë së Serbisë për të hyrë në Kosovë.

Në qershor Rama vazhdonte: “Nuk ka kërcënim për Kosovën nga viti 1999, ai është vetëm në mendjen e politikanëve në Kosovë dhe vetëm një mënyrë për të bërë politikë të brendshme...”. Ky rrezik ka ekzistuar edhe më 2011 kur në pushtet nuk ishte VV, por Hashim Thaçi, i cili e dërgoi policinë speciale në Veri dhe me atë rast terroristët serbë vranë një polic kosovar. Nuk ka punë më të mërzhshme se t’ia shpjegosh një kryeministri të Tiranës historinë e Kosovës të cilën ai - po të donte - do e gjente me dy fjalë të hedhura në Google, por me gjasë duhet bërë edhe kjo punë për të mos lejuar t’i fyhet inteligjenca një populli nga dërdëllitjet e çuditshme të Edi Ramës për Kosovën.

Po në qershor të këtij viti ai thoshte: “Kosova nuk mund të sillt sikur Serbia është kërcënim për Kosovën.” Vërtet, çfarë ka ky njeri? A është aq politikisht i papjekur apo i këshilluar keq nga këshilltarë të këqinj? Apo pushteti i pamatshëm, mandati i tretë, ndjenja e paprekshmërisë, i kanë krijuar atij bindjen se është edhe i pagabueshëm në çdo hap që bën?

3.

Kur nuk shpërndan ndonjë pikturë e pjatë, Edi Rama tregon përralla. Në serinë e përrallave të tij shquhet, së fundi, sidomos krahasimi që i bëri konfliktit të Palestinës me konfliktin e Kosovës. Tha se po e citonte Bill Clinton-in, i cili i paskësh thënë se edhe palestinezët me në krye Jaser Arafatin ashtu si Kosova (më saktë:

ANDI BEJTJA

# PARLAMENTI EUROPIAN E PA SERBINË ME SYTË E ALBIN KURTIT

Sot mund të thuhet pa hezitimin më të vogël, që më në fund, Europa për herë të parë e pa Serbinë me sytë e Prishtinës. Për këtë u desh shumë mund, rezistencë ndaj “stërkëmbëshave” tinëzarë të Tiranës e të disa aktorëve ndërkombëtarë jo pa peshë, u desh shumë “kokëfortësi”, shumë dinjitet dhe fatkeqësisht, pse jo dhe cinikisht u desh edhe një polic dëshmor.

Parlamenti European me një rezolutë të posaçme e dënoi Serbinë më shumë dhe më fort se kurrë, duke e cilësuar 24 shtatorin jo thjesht sulm terrorist të mirëfilltë, por duke u bërë thirrje dhe vendeve të tjera të BE-së që nuk e kanë dënuar këtë sulm të bëjnë të njëjtën gjë, në të njëjtën kohë dhe duke bërë thirrje për heqjen e atyre sanksioneve feminare ndaj Kosovës, gjithashtu duke e bërë të qartë në mënyrë eksplicite se asnjë masë e ngjashme me thirrjet përçarë me pezullimin e vizave nuk mund të kondicionohet me dialogun.

Kjo rezolutë në të njëjtën kohë hodhi në kosh konferencën për shtyp në Tiranë të Makronit me Ramën bashkë me gabimin e përkthyeses së gjorë, ku u fol me ankth për pezullim vizash, duke e nxjerrë Makronin një politikan adoleshent, bashkë me falënderimin e



Vuçiçit për të nga Kina: po hajt të shkuara të harruara, Rama nuk do ketë fatin e keq t'i dridhet mishi nga frika e pezullimit të vizave. Jashtë humorit, përmbledhtazi, minimumi janë

tre shqiptarë që duhet t'i përtypin mirë leksionet që u dha kjo rezolutë.

I pari është Kryeministri Shqipërisë, Edi Rama, i cili në Samitin e Procesit

të Berlinit në Tiranë nuk bëri as një të dhjetën e Kancelarit Gjerman, duke mos bërë asnjë çerek thirrjeje për sanksione ndaj Serbisë, i cili nuk hezitoi ta quante Albin Kurtin Oso Kuka, të qmendur, që do mbetëj i vetëm i izoluar, që në fakt ishte edhe i pari që indirekt i vuri sanksione Prishtinës, duke anuluar mbledhjen e përbashkët të dy qeverive. I dyti padyshim është Abazović, që e quajti Ramën: ‘Baba të Kombit’.

Dhe këtu nuk ia vlen të ndalesh më gjatë. Dhe i treti, politikani dhe biznesmeni Behxhet Pacolli, që na patakasi kur nuk iu drodh qerpiku kur e portretizoi Ramën në një prononcim që është bërë viral në “TikTok” si dhjetëfish më të zgjuar se mesatarja e gjithë liderëve kosovarë,

kosovarëve në përgjithësi, pra përfshirë edhe atë vetë. Aq shumë e pa Europa sot Serbinë me sytë e Albinit, sa në të njëjtën ditë me rezolutën, Komisioni European paraqiti një pako me propozime për të ruajtur më mirë kufijtë e BE-së nga emigrimi ilegal.

Me propozimin e ri, liberalizimi i vizave do të mund të pezullohet edhe për shkak mospërshtatjes të regjimit të vizave të atyre vendeve me regjimin e BE-së për shtetasit e tretë. Burimet e Komisionit, në mënyrë të veçantë kanë përmendur Serbinë që ua kishte hequr vizat vendeve si Kuba, Tunizia apo Burundi... (Ky është dhe një apel indirekt për Shqipërinë në qoftë se nuk heq dorë përfundimisht nga ‘Pasaportat e Arta’ dhe amnistia fiskale).

Konkluzioni shkurt dhe shqip: Europa më në fund e pa dhe me sa duket do të vazhdojë ta shohë Serbinë me sytë e Albinit, por sa kohë dhe çfarë i duhet Ramës, për ta parë Serbinë me sytë e Europës!?

krerët e saj aktualë politikë) nuk paskan nënshkruar një marrëveshje dhe kësijoj e paskëshin humbur shansin e madh historik. Shansin e madh historik për çka?

Kjo është një pyetje e vështirë për Edi Ramën, sepse ai nuk merret me detaje të mërzhitshme të konfliktit të përgjakshëm në Lindjen e Afërt. Ai merret me lakim e përdredhje faktesh që t'i përshtaten propagandës së tij. Meqë është e pamundur të verifikohet se çfarë i paskësh thënë Bill Clinton Edi Ramës gjatë takimit të tyre në Tiranë (në prani të të gjithëpranishmit Alexander Soros, i cili vajton me të drejtë se në Hungari qeveris një autokrat si Viktor Orbani, por në të njëjtën kohë nuk e ka fare problem të pi verë në sallonet e Aleksandër Vuçiçit apo të lavdërojë Edi Ramën si lider të përmasave planetare) - pra, meqë është e pamundur të verifikohet vërtetësia e fjalëve që Edi Rama i hedh në opinion, le të konsultojmë këtu dy shkencëtarë gjermanë që janë njohës të thellë të historisë së konfliktit izraelito-palestinez.

Muriel Asseburg punon për Fondacionin Shkenca dhe Politika në Berlin, një institucion prestigjioz që shkruan analiza për qeverinë gjermane, ndërsa Jan Busse është profesor në Universitetin e Bundeswehrit (armatës gjermane). Këta dy autorë kanë shkruar një libër mbi konfliktin mes Izraelit dhe Palestinës. Ata theksojnë se negociatat në Camp David të ndërmjetësuar nga presidenti Bill Clinton në korrik të vitit 2000 dështuan për shkak se pala izraelite bëri

propozime për opsonin e dy shteteve (një shtet izraelit, tjetri palestinez), të cilat qenë shumë larg “kërkesave minimale” palestineze siç ishin: një territor i Palestinës i ndërlidhur mes vete dhe i bazuar në kufijtë e vitit 1967 me Jeruzalemin lindor si kryeqytet si dhe zgjidhja e çështjes së refugjatëve palestinezë bazuar në Rezolutën 194 të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së.

Asseburg dhe Busse, të cilët kanë mësuar për historinë e Lindjes së Afërt me siguri më gjatë se konferenca për shtyp e Edi Ramës dhe Emmanuel Macron-it në Tiranë, pra këta ekspertë gjermanë thonë se një nga arsytet e dështimit të negociatave në Camp David të SHBA ishte se kryeministri izraelit Ehud Barak dëshironte t'i aneksonte blloqet me kolonizatorë hebraikë në Bregun Perëndimor të lumit Jordan (West Bank) dhe të ruante sovranitetin izraelit mbi mbarë Jeruzalemin. Barak hodhi poshtë edhe të drejtën e kthimit individual të refugjatëve palestinezë.

Shkencëtarët gjermanë Asseburg dhe Busse nënvizojnë se është mit që faji për dështimin e negociatave në Camp David është vetëm i Jaser Arafatit. Ky lexim i ngjarjeve është i gabueshëm, thonë ata. Mbase Edi Rama nuk e di, por do të duhej të kishte një këshilltar që do t'i tregonte se pas Camp Davidit lideri palestinez Arafat nuk i braktisi negociatat - ato vazhduan në Taba, një qytet në kufirin izraelito-egjiptian. Por në janar 2001 bisedimet i braktisi Ehud Baraku, sepse nuk kishte shumicë në Kneset (parlamenti

izraelit). Barakut i mungoi guximi për të vazhduar negociatat, theksojnë ekspertët gjermanë.

Tendenca e Edi Ramës që duke e keqinterpretuar historinë e negociatave izraelito-palestineze ta godasë Kosovën në një moment tepër të vështirë gjeopolitik, tregon mungesën e largpamësisë strategjike. Edi Rama me gjasë mendon se politika shtetërore bëhet me gjeste e me fjalime jokonvencionale që i argëtojnë bashkëbiseduesit perëndimorë në tavolinë. Por qëllimi nuk duhet të jetë argëtimi, por mbrojtja minimale e interesave të shqiptarëve në rajon. Ose së paku mosdëmtimi i këtyre interesave.

Sa i përket Lindjes së Afërt ndoshta i ndihmojnë Edi Ramës këto fakte: më 25 shkurt 1994 oficeri i ushtrisë izraelite dhe terroristi Baruch Goldstein vrau në një xhami në Hebron (për besimtarë të tjerë vendi njihet si Varri i Patriarkut) 29 palestinezë muslimanë dhe plagosi 150. Në mendjen e tij, popullit hebraik i kërcënohej rreziku nga politika paqësore e kryeministrit Jitzhak Rabin. Më 4 nëntor 1995 Rabini, njeriu i paqes, u vra nga ekstremisti hebraik Jigal Amir.

4.

Në mandatet e tij si kryeministër Edi Rama ka lënë shumë gjurmë në Shqipëri dhe vetëm nihlistët do të thoshin se janë vetëm gjurmë të këqija. Jo. Shqipëria sot është më e përparuar se më parë, infrastruktura

është më funksionale, qytetet janë më të gjalla, imazhi i Shqipërisë është më i mirë se në të kaluarën - ndoshta ky është vetëm perceptim, por shifrat e turistëve nga mbarë bota janë një sinjal se Shqipëria mund të shndërrohet në destinacion të rëndësishëm turistik.

Por ana tjetër e medaljes nuk është e ndritshme: si në qeveritë paraprake edhe në këto mandate të socialistëve korrupsioni, keqpërdorimi i pushtetit dhe lidhja e politikanëve me rrjete kriminale mbesin problem serioz. Janë bërë tashmë tre muaj që nga Shqipëria ka ikur ministri i Financave i cili dyshohet për shumë vepra penale. Që nga fundi i korrikut nuk ka ndodhur asgjë dhe nuk dihet a do të arrestohet fare. Ikja e njerëzve nga Shqipëria shkakton debate të ashpra madje edhe në parlamentin britanik.

Edi Rama mund të bërtasë e mllëfoset kundër racizimit perëndimor, por fakti i hidhur mbetet: krimi i organizuar, shpëlarja e parave, kontrabanda me drogë mbeten kancer që gërryejnë Shqipërinë nga brenda dhe shtrihen jo vetëm në Europë. Nga mesi i majit radioja zvicerane transmetoi një reportazh të gjatë mbi zhvillimet në Ekuador, një shtet në Amerikën Latine. Aty thuhet se kundër presidentit Guillermo Lasso kishte filluar procedura e shkarkimit për shkak të keqpërdorimit të financave dhe lidhjes së njerëzve besnikë të tij me mafian shqiptare. Mafian shqiptare në Ekuador? Këto lajme nuk i mbulon dot shija estetike e Edi Ramës.

Nuk është lajm i mirë për të dhe për Shqipërinë që në shumë artikuj të “New York Times” dhe të “Washington Post” emri i Edi Ramës përmendet krahas Charles McGonigal, një zyrtar i lartë i FBI-së amerikane i akuzuar për 100 të zeza - prej marrjes së rryshfetit deri te lidhjet me një oligark rus. Nëse Edi Rama mendon se këto njolla i heq nga biografia e tij politike duke u marrë me Kosovën përmes deklaratave shpesh skandaloze, atëherë është mirë të mësojë nga Sali Berisha. Më 1997 ai duke parë rrezikun e shembjes së piramidave financiare, tentoi ta eksportojë krizën në Kosovë duke bërë thirrje që shqiptarët e Kosovës të përkrahin protestat e opozitës serbe kundër manipulimit të zgjedhjeve lokale në Serbi nga Slllobodan Milloseviçi. Ibrahim Rugova i rezistoi kësaj loje të pandershme të Sali Berishës. Sepse Rugova nuk e kishte hallin kush do bëhej kryetar i Kragujevcit apo Krallëvës në Serbi. Pas këtij incidenti Berisha e Rugova nuk u takuan kurrë më. Përveç se në ditën kur u varros Ibrahim Rugova.

Edi Rama thotë se e ka mik Albin Kurtin. (Ndonëse ndër fjalët më boshe në politikë është fjala “mik”). Sidoqoftë, të dy, Ramën e Kurtin, i bashkon një gjë: dëshira për të ligjësuar. Do të ishte në të mirën e Shqipërisë dhe Kosovës që ata të mos i ligjëronin njëri-tjetrit, por të dakordoheshin për të ligjësuar bashkë disa parime që kanë parasysh interesat e përgjithshme të shqiptarëve në rajon. © Enver Robelli - KOHA

*Akoma nuk keni një website?*



**Akoma nuk jeni  
regjistruar në  
Google?**

*Porosit  
websitin tend*

**Për çdo konsultim mund të vini tek zyrat tona**

**Adresa e zyrave: 30 Avenons Road  
London E13 8HT**

**NA KONTAKTONI:**

**TEL: 020 7018 7929**

**MOB: 073 4066 5946**

**MOB: 078 5997 7545**





# Te gjitha e Ballkanit ne nji Market produktet

318-324 Kilburn High Road, London, NW6 2QN | Tel: 020 7372 1059



# AKOMA NUK KENI NJË WEBSITE?

Akoma nuk jeni  
regjistruar në  
Google?!

**Për çdo  
konsultim  
mund te vini  
në zyrat tona**

*The Albanian*

**Adresa e zyrave:  
30 Avenons Road  
London E13 8HT**

**Na kontaktoni:**

**020 7018 7929  
073 4066 5946  
078 5997 7545**



**NE MUND TIU  
NDIHMOMJME EDHE ME:**

- Business Cards
- Logos
- Invoices
- Posters
- Quotations
- Banners
- Flyers
- Video Marketing
- Online Marketing
- Etc